

AKTIVITETI I SHERBIMIT LIGJOR FALAS TIRANE
(TIRANA LEGAL AID SOCIETY), TLAS, 2019

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS, gjate vitit 2019, ka qënë dhe vazhdon të jetë një ndër aktorët aktiv në procesin e përmirësimit të sistemit të drejtësisë në vendin tonë. Dihet tashmë që Reforma në drejtësi ka hyrë në pjesën më të vështirë dhe të rëndësishme si edhe është shoqëruar me ndryshime pozitive dhe negative, me impakt të drejtpërdrejtë në funksionimin apo mos funksionimin e sistemit gjyqësor dhe atij të drejtësisë në përgjithësi. Ndihet që besimi i qytetarëve për funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe performancën e aktorëve të tij institucionalë po shoqërohet me një ndjenjë ende të mosbesimit dhe pesimizmit. Duhet theksuar që edhe gjatë 2019 mos funksionimi i zbatimit të ligjit të ndihmës juridike ka cënuar dhe ndikuar në aksesin në drejtësi të qytetarëve. Prandaj dhe shërbimet ligjore falas të ofruara nga organizata të specializuara për këtë qëllim, mbeten pjesë shumë e rëndësishme e këtij sistemi, janë ato që plotësojnë boshllëkun e pambuluar nga ndihma juridike shtetërore dhe që garantojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve në nevojë.

Gjatë vitit 2019 stafi i TLAS ka ofruar ndihmë juridike për të asistuar drejtpërdrejt **1739** çështje ligjore që i përkisnin fëmijëve, të papunëve, personave me aftësi të kufizuara, pensionistëve, grupit LGBTI, minoriteteve dhe familjeve të tjera në nevojë. Këta përfitues kanë mbetur të kënaqur nga rezultate e zgjidhjes sepse më shumë se 96 % e rasteve janë finalizuar me sukses në favor të përfituesve direkt të shërbimit. Përfituesit dëshmojnë dhe vlerësojnë ndihmën juridike falas që jo vetëm ka rritur aksesin e tyre në drejtësi por mbi të gjitha ka mundur aksesin e tyre në programet sociale dhe përmirësimin e situatës së tyre ekonomike.

Gjatë 2019, TLAS ka synuar përfaqësimet ligjore strategjike si përpara administratës shtetërore ashtu dhe para gjykatës, si edhe forcimit të partneritetit efektiv me strukturave shtetërore, me NGO-të partnere apo përfaqësuesit në nivelin lokal në mënyrë që të plotësohet shërbimi ndaj shtresave apo individëve më të marginalizuar, **mbrojtjes së të drejtave të tyre përmes:**

- **Përcaktimit** me përparësi të llojeve të shërbimeve për fëmijët, familjet vulnerabël dhe qytetarët e tjerë të varfër
- **Përmirësimit** të aftësive të klientëve për të zgjidhur vet problemet ligjore nëpërmjet trainimit individual dhe në grup me drejtues ose përfaqësues të komunitetit, nëpërmjet ofrimit të formularëve të gatshëm e të lehtë për t'u përdorur.
- **Identifikimit** të çështjeve ligjore përmes përdorimit të TLAS Portal, i cili synon të orientojë personat në nevojë si t'i zgjidhin ato.
- **Zgjerimit të** struktureve të tij dhe partnerëve apo aktorëve të tjerë qeveritarë dhe joqeveritarë për të ndërtuar besimin te individët në nevojë dhe krijuar një realitet tjetër në funksion të zhvillimeve të mëtejshme të demokracisë në Shqipëri.
- **Rritjes së kapaciteteve** të profesionistëve, seminareve të trajnimit, ëorkshopeve dhe tryezave të shumta në të gjithë vendin
- **Ofrimit të shërbimeve** ligjore mobile, aktiviteteteve të street laë, shërbimeve hotline, përdorimit të teknologjisë është bërë e mundur që të përfitojnë individë vulnerabël edhe nga rrethet e tjera të largëta si Peshkopia, Gjirokastra, Kukësi, etj.

- **Nismave** për përmirësimin e legjislacionit që ndikon në jetën e individëve në nevojë dhe advokimit e lobimit për miratimin dhe zbatimin e tyre.
- **Aktivitetet e ndërgjegjësues dhe publikimeve me** informacione për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të fëmijëve apo grupeve të tjera vulnerabël.
- **Forcimit të rolit aktiv** në rrjetet lokale dhe rajonale për çështje prioritare si shtetësia, aksesit në drejtësi, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, grave, të personave të privuar nga liria, etj.

Edhe pse financimi mbetet për cdo vit një sfidë e vërtetë, TLAS ka arritur të sigurojë mjaftueshëm fonde dhe të jetë eficient në shërbimet e tij, bazuar në shmillojshmerinë e formave të ofrimit, në cilësinë e lartë dhe me kosto të ulët. Pikërisht këtë model po përpiqemi ta promovojmë jo vetëm në Tiranë por edhe në të gjithë territorin e vendit në mënyrë që fondet e donatorëve të përdoren sa më mirë dhe për t'i shërbyer sa më shumë individëve.

Synimi i TLAS në këtë analizë vjetore është rritja e aksesit në drejtësi dhe në programet ekonomike e sociale. Ne synojmë nga njëra anë të mundësojmë ndryshimet e nevojshme në sistemin e drejtësisë, dhe nga ana tjetër të ofrojmë shërbimet e përditshme për personat që kanë më shumë nevojë, duke sjellë sado pak ndryshim në jetët e tyre dhe në shoqërinë shqiptare.

Një tjetër synim ka qënë ngritja e kapaciteteve dhe nxitja e profesionistëve të fushës së arsimit, shëndetësisë, gjëndjes civile, shërbimit social shtetëror, për t'u përfshirë në mënyrë më të koordinuar në funksion të zgjidhjes së halleve të atyre që kanë më shumë nevojë.

Së fundmi, TLAS-i vlerëson në mënyrë të vecantë, kontributin, përkushtimin dhe angazhimin e ekspertëve, anëtarëve të stafit dhe vullnetarëve. TLAS beson se të gjithë njerëzit duhet të jenë të barabartë përballë ligjit; se drejtësia duhet të jetë njësoj për të gjithë dhe se duhet të ketë një sistem ligjor që është i lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u zbatuar.

Një falenderim shumë i vecantë dhe i drejtohet donatorëve që kanë mbështetur programin e TLAS gjatë 2019 kanë qënë **UNDP, UNHCR, Dutch Embassy, EU/Save The Children, Partners Albania, Eörd Vision, etj.**

FUSHA E LIGJIT NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

TLAS vazhdoi gjatë vitit 2019 të ofrojë shërbime ligjore për çështjet civile, administrative, familjare dhe të punës si dhe për rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut; në formën e këshillimit, dhe të përfaqësimit si në organet administrative edhe në ato gjyqësore. Shërbimi Ligjor Falas i TLAS është i fokusuar tek familjet më të varfra, tek fëmijët vulnerabël, pensionistët, Grupi LGBTI, individë me aftësi të ndryshme, dhe kryesisht duke synuar për fshirjen e tyre sociale.

Numri total i përfituesve të drejtpërdrejtë nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS, gjatë 2019 ka qënë **1739** klientë, dhe numri total i të gjithë përfituesve të drejtpërdrejtë gjatë 21 vjetëve të funksionimit të shërbimit ligjor falas, TLAS, ka arritur shifrën **25953** klientë¹. Përqindja e shkallës së suksesit të çështjeve të përfaqësuara përpara gjykatave dhe strukturave administrative gjatë 2019 është si më poshtë :

¹ Më poshtë paraqitet diagrama sipas numrit të përfituesve direkt në harkun kohor të 19 viteve

Tabela më poshtë tregon rrugën e ndjekur për të zgjidhur çështjet ligjore të paraqituara në TLAS:

Lloji i shërbimit të ofruar ne 2017	Numri i rasteve	Mbyllur në favor të klientit
Përfaqësime në gjykatë	252	97 %
Përfaqësim në administratë	699	95 %
Shërbyer me ndihmë parësore dhe kliniks	788	n/a
Total	1739	

Më poshtë gjeni diagramën progresive të përfituesve të drejtpërdrejtë të shërbimeve ligjore falas vit pas viti që nga themelimi i TLAS:




Tabela jep ngarkesën mujore të stafit që ofron shërbime ligjore për një total prej 1739 përfitues të drejtë përdrejtë gjatë vitit 2019:

Ndjekur	Status	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Aug	Shta	Tet	Nov	Dhj
Avokatët	hapur	118	158	188	221	246	272	301	304	337	368	387	403
	mbyllur	10	22	45	67	94	124	152	157	192	227	262	299
	aktive	108	136	143	154	152	148	149	147	145	141	125	104
Paraligjorët	hapur	323	463	554	632	756	873	964	970	1077	1190	1298	1336
	mbyllur	50	107	185	245	365	491	603	732	898	1000	1078	1161
	aktive	273	356	369	387	391	382	361	228	179	190	220	175
Total	hapur	441	621	742	853	1002	1145	1265	1274	1414	1558	1685	1739
	mbyllur	60	129	230	312	485	615	755	889	1090	1227	1340	1460
	aktive	381	492	512	542	517	530	510	385	324	331	348	279

Lloji i çështjeve gjyqësore	total
Regjistrime lindjesh	47
Pavlefshmeri Akti Lindje, Martese, Vdekje	12
Koregjim material, Emri, Mbiemri, Datelindje, Vendlindje	21
Njohje atesie, amesie	19
Kundershtim atesie	36
Zgjidhje Martese	53
Kujdestari	35
Pergjegjesi prinderore	10
Shperblim demi	16
Heqje zotësie për të vepruar, pension, iterseks	3
total	252

Sic shihet në tabelen e mësipërme nga 252 çështje që janë ndjekur në rrugë gjyqësore nga avokatët e TLAS gjatë Vitit 2019, 104 prej tyre nuk janë mbyllur ose finalizuar brenda këtij harku kohor. Çështjet hapen sipas përkatësisë së vend banimit të përfituesve, duke i depozituar kërkesat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në të gjithë vendin, dhe rezulton që një numër i vogël prej tyre ankimohen në shkallët e tjera të gjyqësorit. Konkretisht nga viti 2019 janë mbartur 102 çështje të hapura në proces, nga të cilat vetëm një çështje është në Gjykatën e Lartë, një çështje gjykatën e Apelit Administrativ, dy në Gjykatën e Apelit dhe tre çështje janë në Gjykatën e Të Drejtave të Njeriut në Strasburg.


Vështirësitë e punës me gjykata janë ndjerë në mënyrë të vecantë gjatë vitit 2019 sepse:

- për shkak të vetingut, gjykatat nuk kanë punuar me kapacitet të plotë stafi, kanë munguar në mënyrë të ndjeshme gjyqtarët,
- ndryshimeve të legjislocionit dhe në vëcantë nga të Kodit të Procedurës Civile, i cili nga gjyqtarë të ndryshëm është interpretuar në mënyra të ndryshme, duke shtuar burokracinë, pushimin shpesh të pajustificuar të çështjeve, të gjitha në kurriz të kohëzgjatjes së çështjeve, të rritjes së

kostove për paraqitjen e përsëritur të provave dokumentave të kërkuara, kostove të udhëtimeve dhe humbjes së kohës për finalizimin e çështjeve delikate që kanë të bëjnë me interesin më të lartë të fëmijëve, etj.


Për të parë se cilat kategori vulnerabël kanë përfituar nga shërbimet ligjore falas të TLAS gjatë vitit 2019, po japim të dhënat si më poshtë:

Grupet përfituese	Ndjekur nga paraligjorët	Ndjekur nga Avokatët	Total
Fëmijët	457	73	530
Nëna Kryefamiljare	277	118	395
Me aftësi ndryshe	17	1	18
Të pa Punë	287	138	425
Të moshuar pa te ardhura	45	2	47
Pensionistë	61	3	64
Familje të varfëra	192	68	260
Total:2019	1336	403	1739



Numri i përfituesve sipas llojit të çështjes gjatë 2019:

Lloji i Çështjes	Ndjekur nga Paralegal	Ndjekur nga avokatët	Total
Regjistrim lindje	457	73	530
Regjistrime civile	167	32	199
Zgjidhje martese	243	90	333
Çështje Familjare	108	187	295
Strehim/ mbrojtje sociale	159	0	159
Vlerësim psikologjik	3	7	10
Te drejta te tjera ligjore	199	14	213
Total: 2019	1336	403	1739



Mbas 21 vjetësh aktivitet dhe experience në fushën e ofrimit të shërbimeve ligjore falas, TLAS është sa i njohur edhe po aq i kërkuar nga përfituesit, nga partneret dhe antarët e rrjetit të krijuar në zonat e targetuara dhe ndërhyrjes në të gjithë territorin e vendi në përputhje me projektet e mbështetura nga donatorët tanë. Bashkëpunorët tanë dhe përfituesit e drejtpërdrejtë tashmë janë të mirëorientuar për të përdorur telefonin pa pagese të zyrës, aksesuar adresën në Tiranë , drejtuar emaille të drejtpërdrejta por edhe përmes faqes së internetit dhe Portalit të TLAS të dedikuar për këtë qëllim.

Gjatë vitit 2019 pati disa burime referimesh dhe rekomandimesh në TLAS nga partnerë apo rrjeti i ndërtuar tashmë i bashkëpunimit me aktorë të interesuar dhe organizata komunitare nga i gjithë vendi:

	Burimet e referimit të rasteve/përfituese në TLAS gjatë 2019	Numri Përqindja
1	Zyrat e Gjendjes Civile	146 = 8.4%
2	Njesitë e mbrojtjes së fëmijëve/CPU	174 = 10%
3	Klient direkt	781 = 45%
4	OJF/Organizata me bazë komunitare	162 = 9.3%
5	Shërbimi Social	78 = 4.5%
6	Ëeb/Portal/Email	226 = 13%
7	Netëork/LAN	172 = 9.8%
	Nr. Total i përfituesve të drejtpërdrejtë	1739 ose 100 %

Objektivat e përcaktuara nga TLAS për 2019 janë arritur në përputhje me kontratat e nënshkruara me donatorët, edhe pse zhvillimet dhe ndryshimet e diktura nga reformat e ndryshme të ndërmarra kudo nga qeveria shqiptare si në sistemin e ekonomisë, atë social, territorial apo të drejtësisë kanë qënë intensive, me efekte të drejtpërdrejta dhe të paparashikuara për jetët e familjeve apo individëve vulnerabël.

Përsa i përket objektivit 2, të rritjes së ndërgjegjësimit të grupeve në nevojë dhe të aktorëve që ofrojnë shërbime ndaj tyre, TLAS ka zbatuar një sërë aktivitete të rëndësishme. Organizimi tradicional shumë vjeçar dhe i sukseshëm i TLAS i aktiviteteve street laë në të gjitha zonat e ndërhyrjes ka bërë që të vizitohen dhe takohen qytetarë në komunitetet më vulnerabel në shkallë vendi.

Gjatë këtyre vizitave me programe dhe synime të catuara, janë takuar 996 individë/qytetarë me të cilët është folur rreth nevojave ligjore që kanë, pengesave që hasin dhe rrugët e adresimit të çështjeve, ku një pjesë të konsiderueshme e zënë shërbimet që ofron TLAS në forma dhe rrugë të ndryshme. Po ashtu gjatë takimeve e vizitave në njësitë administrative të zonave ku është zhvilluar Street Laë sipas tabelës së mëposhtme, janë shpërnadrë edhe shumë publikime që TLAS i përgatit në mënyrë të posacme me informacione ligjore në gjuhë të thjeshtë për publikun e gjërë dhe në vëcanti për grupet e targetuara.

2/1 Street- Laë gjatë 2019 janë zhvilluar në komunitetet vulnerabel si më poshtë :

NR	Vendi: njësitë administrative dhe bashkitë	Data	Nr i qytetareve te takuar	Nr i publikimeve te shperndara
1	Berat	26.02.2019	64	128
2	Arras	02.04.2019	28	40
3	Arras	24.04.2019	25	25
4	Elbasan	17.05.2019	46	100
5	Lushnje	16.05.2019	84	100
6	Berat	20.05.2019	70	95
7	Tomin	20.05.2019	26	35
8	Shupenze	24.05.2019	25	25
9	Shupenze	07.05.2019	24	30
10	Kala e Dodes	14.06.2019	25	30
11	Tirane Lana Bregas	12.06.2019	130	141
12	Lezhe	10.07.2019	25	50
13	Lac	10.07.2019	35	33
14	Shkoder	10.07.2019	50	102
15	Lezhe	11.09.2019	25	30
16	Shkoder	11.09.2019	93	52
17	Tirane Shkoze	07.10.2019	100	102
18	Lac	14.11.2019	30	25
19	Elbasan	05.11.2019	44	150
20	Berat	01.11.2019	36	94
21	Fier	19.12.2019	41	93
22	Fier	19.12.2019	70	131
Total	22	22	1096	1,661

2/2 Trajnime të ofruara nga ekspertët e TLAS gjatë 2019 për 307 pjesmarrës sipas tabelës më poshtë, (tematikat dhe perfituesit jepen me detaje në krah të fotove në vazhdim)

Nr.	Datë	Vendi	Nr. i pjesëmarrësve
1	15.02.2019	Tiranë, Hotel “Mondial”	41
2	15.02.2019	Shkodër, Hotel “Colosseo”	19
3	08.07.2019	Tiranë, Dhoma e Avokatisë	27
4	09.07.2019	Tiranë, Dhoma e Avokatisë	27
5	10.07.2019	Tiranë, Dhoma e Avokatisë	28
6	11.10.2019	Librazhd, Qendra “Eorl Vision”	31
7	15.10.2019	Korçë, Qendra “Eorl Vision”	27
8	13.11.2019	Kurbin, Qendra Multifunksionale	23
9	14.11.2019	Berat, Bashkia	30
10	15.11.2019	Fier, Hotel “Fieri”	31
11	28.05.2019	Selanik, Ambasada Shqiptare	8
12	29.05.2019	Athinë, Ambasada Shqiptare	7
13	30.05.2019	Janinë, Ambasada Shqiptare	8
Total	13	13	307

2/3 Tryeza diskutimi, Sesione informuese, Monitorime për 346 përfitues (tematikat dhe perfituesit jepen me detaje në krah të fotove në vazhdim)

Nr.	Datë	Vendi	Nr. i pjesëmarrësve
1	01.02.2019	Tiranë, Hotel “Xheko Imperial”	43
2	27.02.2019	Tiranë, Hotel “Xheko Imperial”	28
6	08.10.2019	Tiranë, Ministria e Drejtësisë	59
7	09.10.2019	Tiranë, Hotel “Xheko Imperial”	35
8	11.10.2019	Elbasan, Bashkia	32
9	21.11.2019	Tiranë, Shkolla e Mesme Kamëz	17
10	22.11.2019	Kurbin, Shkolla e Mesme	39
11	22.11.2019	Lezhë, Shkolla e Mesme	14
12	25.11.2019	Korçë, Shkolla e Mesme	16
13	04.12.2019	Selanik, Ambasada Shqiptare	6
14	05.12.2019	Athinë, Ambasada Shqiptare	5
15	06.12.2019	Janinë, Ambasada Shqiptare	4
16	12.12.2019	Tiranë, Hotel “Xheko Imperial”	22
17	18.12.2019	Librazhd, Shkolla e Mesme	26
Total	17	17	346

Aktivitet e 2019

1. TRYEZË E RRUMBULLAKET



Vëndi : Hotel “ Xheko Imperial”, Tiranë
Datë : 01 Shkurt 2019
Tema “Konsultimi i 6 akteve nënligjore në zbatim të ndryshimeve të ligjit të gjendjes civile”
Donator : UNHCR
43 pjesmarrës

2. TRAJNIME




Vendi : Hotel Mondial, Tiranë
Datë : 15 Shkurt 2019
Tema : “Rritja e përfshirjes sociale përmes zgjidhjes së të drejtave ligjore”
Donator : PARTNERS ALBANIA
41 pjesmarrës



Vendi : Hotel Colosseu , Shkoder
Datë : 15 Shkurt 2019
Tema : “Rritja e përfshirjes sociale përmes zgjidhjes së të drejtave ligjore”
Donator : PARTNERS ALBANIA
19 pjesmarrës



Vendi : Hotel Univers, Elbasan
 Datë : 26 Shkurt 2019
 Tema : “Rritja e përfshirjes sociale përmes zgjidhjes së të drejtave ligjore”
 Donator : PARTNERS ALBANIA
 27 pjesmarrës



Vendi : Dhoma Kombëtare e Avokatisë Tiranë
 Datë : 08 Korrik 2019
 Tema : Përmirësimi i njohurive të avokatëve ex-offico për të “Drejtën Penale”
 Donator : BRRLN
 27 pjesmarrës

Vëndi : Dhoma Kombëtare e Avokatisë Tiranë
 Datë : 08 Korrik 2019
 Tema : Përmirësimi i njohurive të avokatëve ex-offico për të “Drejtën Penale”
 Donator : BRRLN
 27 pjesmarrës



Vendi : Dhoma Kombëtare e Avokatisë Tiranë
 Datë : 09 Korrik 2019
 Tema : Përmirësimi i njohurive të avokatëve ex-offico për të “Drejtën Penale”
 Donator : BRRLN
 27 pjesmarrës



Vëndi : Dhoma Kombëtare e Avokatisë Tiranë
 Datë : 10 Korrik 2019
 Tema : Përmirësimi i njohurive të avokatëve
 ex-officio për të “Drejtën Penale”
 Donator : BRRLN
 28 pjesmarrës



Vëndi : Qendra World Vision, Librazhd
 Datë : 11 Tetor 2019
 Tema : Ngritja e kapaciteteve të
 bashkëpunorëve pwr evidentimin, referimin
 dhe zgjidhjen e nevojave ligjore të fëmijëve
 dhe familjeve të tyre
 Donator: WORLD VISION
 31 pjesmarrës



Vëndi : Qendra World Vision, Korce
 Datë : 15 Tetor 2019
 Tema : Ngritja e kapaciteteve të
 bashkëpunorëve pwr evidentimin, referimin
 dhe zgjidhjen e nevojave ligjore të fëmijëve
 dhe familjeve të tyre
 Donator: WORLD VISION
 27 pjesmarrës



Vëndi : Qendra multifunktionale Kurbin
 Datë : 13 Nëntor 2019
 Tema : Ngritja e kapaciteteve të bashkëpunorëve për evidentimin, referimin dhe zgjidhjen e nevojave ligjore të fëmijëve dhe familjeve të tyre
 Donator: WORLD VISION
 23 pjesmarrës



Vëndi : Bashkia, Berat
 Datë : 14 Nëntor 2019
 Tema : Të rrisim përfshirjen sociale të emigrantëve përmes aksesit në drejtësi
 Donator : IRIS
 30 pjesmarrës



Vëndi : Hotel Fieri
 Datë : 15 Nëntor 2019
 Tema : Të rrisim përfshirjen sociale të emigrantëve përmes aksesit në drejtësi.
 Donator : IRIS
 31 pjesmarrës



Vëndi : Ambasada Shqiptare, Selanik
 Datë : 27 Maj 2019
 Tema : Regjistrimet civile, e drejta për identitet, shkaqet e pashtetësisë, pasojat , rruget e zgjidhjes
 Donator : ENS
 8 pjesmarrës



Vëndi : Konsullata Shqiptare Athinë
 Datë : 28 Maj 2019
 Tema : Regjistrimet civile, e drejta për identitet, shkaqet e pashtetësisë, pasojat , rruget e zgjidhjes
 Donator : ENS
 7 pjesmarrës



Vëndi : Konsullata Shqiptare Janinë
 Datë : 31 Maj 2019
 Tema : Regjistrimet civile, e drejta për identitet, shkaqet e pashtetësisë, pasojat , rruget e zgjidhjes
 Donator : ENS
 8 pjesmarrës

3. TRYEZA DISKUTIMI, SESIONE INFORMUESE



Vëndi : Shkolla e Mesme Kamëz, Tiranë
Datë : 21 Nëntor 2019
Tema : Të zgjerojmë aksesin në drejtësi për fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre përmes shërbimeve ligjore falas.
Donator : WORLD VISION
17 pjesmarrës



Vëndi : Shkolla e Mesme Kurbin
Datë : 22 Nëntor 2019
Tema : Të zgjerojmë aksesin në drejtësi për fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre përmes shërbimeve ligjore falas.
Donator : WORLD VISION
39 pjesmarrës



Vëndi : Shkolla e Mesme Lezhë
Datë : 22 Nëntor 2019
Tema : Të zgjerojmë aksesin në drejtësi për fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre përmes shërbimeve ligjore falas.
Donator : WORLD VISION
14 pjesmarrës



Vëndi : Shkolla e Mesme Korçë
 Datë: 25 Nëntor 2019
 Tema : Të zgjerojmë aksesin në drejtësi për fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre përmes shërbimeve ligjore falas
 Donator : WORLD VISION
 16 pjesmarrës



Vëndi : Shkolla e Mesme Librazhd
 Datë : 18 Dhjetor 2019
 Tema : Të zgjerojmë aksesin në drejtësi për fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre përmes shërbimeve ligjore falas.
 Donator : WORLD VISION
 26 pjesmarrës



Vëndi : Hotel Xheko Imperial, Tiranë
 Datë : 27 Shkurt 2019, 9 Tetor 2019, 12 Dhjetor, 2019
 Tryeza Diskutimi : Fuqizimi i të drejtave të personave interseks në Shqipëri
 Donator : MATRA
 Respektivisht 28, 35, 22 pjesmarrës



Vëndi : Ministria e Drejtësisë, Tiranë
 Datë : 08 Tetor 2019
 Tryeze Informimi për projektin : “Akses në Drejtësi për të gjithë”, me përfaqësues të partnerëve dhe bashkëpunëtorëve nga Tirana, Berati dhe Fieri.
 Donator : SWISS Embassy, Tiranë
 59 pjesëmarrës



Vëndi : Bashkia, Elbasan
 Datë : 11 Tetor 2019
 Tryeze Informimi për projektin : “Akses në Drejtësi për të gjithë”, me përfaqësues të partnerëve dhe bashkëpunëtorëve nga Tirana, Berati dhe Fieri.
 Donator : SWISS Embassy, Tiranë
 32 pjesëmarrës

3. Ndermarrja e Nismave për studime dhe përmirësime të legjislacionit të shoqëruara me fushata advokimi dhe lobimi, ka shënuar gjithashtu një arritje të mëtejshme duke e pasuruar më gjërë listën e draftimeve të reja, të amendamenteve dhe të akteve nënligjore.

3/1 Grupi i ekspertëve të TLAS ka draftuar ligjin e ri “PËR AZILIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Republika e Shqipërisë ka tashmë një sistem azili për të cilin po punohet gjithmonë e më shumë, për t’iu afruar standardeve evropiane, duke realizuar funksionimin e plotë të procedurave në përcaktimin e statusit të refugjatit për personat që kërkojnë azil.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e datës 10 dhjetor 1948, në nenin 14, përcakton se: *“1. Secili ka të drejtë të kërkojë dhe të gëzojë vendstrehim në vende të tjera për shkak të përndjekjes. 2. Këtë të drejtë nuk mund ta kërkojë askush në rast të përndjekjeve që mbështeten vërtet në veprimet e*

rëndomta penale ose në veprimet që janë në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.”

Republika e Shqipërisë aderon në konventën “Për statusin e refugjatëve”, nënshkruar në Gjenevë, më 28.7.1951, dhe në protokollin “Për statusin e refugjatëve”, nënshkruar në Nju Jork, më 31.1.1967. Në konventën e OKB-së është aderuar me anë të dekretit të Presidentit të Republikës nr.200, datë 3.6.1992. Më pas, Shqipëria ka nënshkruar dhe miratuar edhe marrëveshjen ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, nëpërmjet ligjit nr.7833, datë 22.6.1994, të shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës me nr. 878, datë 6.7.1994.

Shqipëria ka ratifikuar, gjithashtu, edhe konventën e vitit 1954, lidhur me statusin e personave pa shtetësi, si dhe konventën e vitit 1961 për reduktimin e pashtetësisë, duke pranuar edhe disa instrumente ndërkombëtare dhe rajonale mbi të drejtat e njeriut, të cilat, gjithashtu, kanë rëndësi për mbrojtjen e refugjatëve.

Përmes këtyre akteve, Shqipëria është radhitur në krah të atyre vendeve juridikisht të qytetëruara, duke promovuar dhe përhapur vlerat e njerëzimit dhe duke u bërë pjesë e konventave ndërkombëtare, si për shembull Konventa e Gjenevës së vitit 1951 dhe protokollin i Nju Jorkut në fushën e azilit, duke krijuar një sistem efektiv të azilit, të fushës të të drejtave dhe detyrimeve për azilkërkuesit, refugjatët, personat në mbrojtje dhe autoritetet përgjegjëse.

Gjithashtu, neni 80, i Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit përcakton se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në këtë fushë do të përqendrohet në zbatimin e legjislacionit të brendshëm për përmbushjen e standardeve të Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe protokollit të Nju Jorkut të vitit 1967, për të siguruar, në këtë mënyrë, respektimin e parimit të moskthimit (*non – refoulment*) të individit në atë vend që përbën kërcënim për jetën e tij, si dhe të të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Po ashtu çështjet e trajtimit të azilkërkuesve janë bërë një subjekt gjithnjë edhe më i shpeshtë i trajtimit edhe nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, në zbatim të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Duke qënë se kjo Konventë dhe autoriteti i Gjykatës së Strasburgut kanë një vend të veçantë në Kushtetutën dhe të drejtën e brendshme në Shqipëri, ky fakt përbën një shtysë tjetër për rregullimin me të plotë ligjor dhe në përputhje me detyrimet/standartet ndërkombëtare të fushës së azilit në Republikën e Shqipërisë.

Në kuadër të procesit të vlerësimit të plotësisht të kushteve për anëtarësim të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, megjithëse në vlerësimin përfundimtar të ekspertëve të shteteve anëtare, legjislacioni për azilin u vlerësua pozitivisht, në raportin e vlerësimit dhe në një sërë takimesh të tjera janë dhanë disa rekomandime në interes të përmirësimit të tij. Nga ana tjetër, nga viti 2014 deri në ditët e sotme organizmat shtetërorë që merren me zbatimin e këtij ligji kanë identifikuar disa të meta dhe paaqartësi në interpretim dhe zbatim, të cilat gjejnë zgjidhje të plotë ligjore në projektligjin e paraqitur.

Projektligji synon përputhshmëri të plotë me *acquis communautaire* në fushën e azilit.

Ndër synimet kryesore të këtij projektligji është forcimi dhe përmirësimi i mëtejshëm sipas kuadrit ligjor ndërkombëtar i politikave në fushën e azilit dhe që shërbejnë në forcimin e aftësive të shtetit shqiptar për të garantuar zbatimin e angazhimeve e të detyrimeve komunitare të BE-së në funksionimin e të gjithë përbërësve të sistemit të azilit, është zbatimi me korrektësi i parimit juridik ndërkombëtar i njohur nga e drejta ndërkombëtare zakonore e moskthimit dhe i të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve

nga agjencitë ligjzbatuese, si dhe trajtimi në mënyrë të barabartë me shtetasit e vendeve të treta që qëndrojnë ligjërisht në territorin shqiptar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Shqipëria është një nga vendet që ka vendosur Axhendën 2030 si pjesë e prioriteteve të veta kombëtare dhe gjithashtu ka mirëpritur Marrëveshjen Globale mbi Migracionin dhe objektivat e saj. Vendimi i Qeverisë Shqiptare për të rinovuar strategjinë ndër-sektoriale për migracionin paraqet një hap të rëndësishëm në realizimin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e migracionit.

Një stimul tjetër drejt miratimit të një qasjeje të integruar për menaxhimin e migracionit është procesi i integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Për të përfunduar me sukses negociatat për Kapitullin 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria) të *Acquis* të BE-së, e cila përcakton qeverisjen e migracionit si një çështje thelbësore, Shqipëria duhet të formulojë një strategji ndër-sektoriale të migracionit. Kjo kërkesë është theksuar gjithashtu në Raportin e Progresit të BE-së për Shqipërinë për vitin 2018.

Një hap i rëndësishëm drejt arritjes së një politike gjithëpërfshirëse të qeverisjes së migracionit ishte miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2016-2020. Në përputhje me vizionin strategjik të SKZHI-së, "*për të krijuar një sistem efektiv të qeverisjes të migracionit në Shqipëri*", Kryeministri ngriti një Grup Pune Ndërinstitucional. Ky grup nga ana e tij ka formuluar Strategjinë e re për Qeverisjen e Migracionit për Shqipërinë 2019-2022, e cila është aktualisht në fazën e konsultimit publik.


Ky projektligj hartohet në kuadër të këtij vizioni strategjik dhe përbën një hap të rëndësishëm në përfundimin e legjislacionit shqiptar me zhvillimet e rëndësishme që ka pësuar legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e azilit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Njësoj si vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria është prekur nga flukset e përziera migratore të cilat përbëhen, ndër të tjera, nga refugjatët dhe azilkërkuesit, migrantët, viktimat e trafikimit, të miturit e pashoqëruar dhe të ndarë, dhe personat pa shtetësi. Disa prej tyre futen në më shumë se një nga këto kategori. Ata vijnë nga shtetësi të ndryshme, ku shumica janë sirianë dhe afganë dhe shpesh hyjnë në vend pa leje hyrjeje. Në të shumtën e rasteve, këta migrantë janë në një situatë të caktuar vulnerabiliteti për shkak të situatës në vendet e tyre të origjinës prej të cilave janë larguar, për shkak të kushteve të vështira, ose shfrytëzimit dhe abuzimit të pësuar përgjatë udhëtimit². Këto flukse kalojnë kryesisht tranzit në Shqipëri përpara se të hyjnë në vendet e Bashkimit Evropian.

² Programi i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2017-2021

Figura 2. Migrantë të parregullt të kapur në territorin e Shqipërisë(2009-2017)




Migracionit 2017, Ministria e Brendshme, Republika e Shqipërisë

Një vlerësim i shpejtë i kryer nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri në vitin 2018, tregon një rritje të mprehtë të numrit të personave të ndaluar në zonat kufitare - 3,088 persona janë ndaluar në gjashtë muajt e parë të vitit 2018, krahasuar me 1049 në vitin 2017. Kjo rritje shoqërohet edhe me një rritje të numrit të kërkesave për azil – 1,901 në gjysmën e parë të vitit 2018, nga 309 në vitin 2017 (Fig.3). Këto shifra janë në fakt më të larta se ato të regjistruara në vitin 2015, gjatë pikut të fluksit të migrantëve në mbarë Evropën.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga IOM për periudhën Dhjetor 2015 deri në Shkurt 2018, 297 persona janë përpjekur të kalojnë kufijtë shqiptarë më shumë se një herë (përsëritës). Rritja e kërkesave për azil ka të ngjarë të vazhdojë. Skenari më optimist i ndërtuar nga ky studim në bazë të analizës së rritjes së hyrjeve dhe larmishmërisë së origjinës të këtyre hyrjeve, tregon se numri i kërkesave për azil do të arrijë në 3,000 në vitin 2019 për 6,000 hyrje gjithsej; ndërkohë që skenari pesimist tregon gjithsej 7,500 kërkesa për azil në vitin 2019 për 13,000 hyrje gjithsej.

Figura 3. Mbërritjet dhe Azili 2015 – 2018




Burimi: UNHCR (2015-2017 statistika zyrtare nga QSH / 2018 UNHCR & QSH)

Lidhur me vendet e origjinës, në vitin 2018, 48% e të ndaluarve deklarojnë se janë nga Siria (1338; prej të cilëve 984 kërkesa për azil) të ndjekur nga shtetësi të tjera si Pakistani (443, prej të cilave 307 kërkesa për azil), Iraku (235 prej të cilave 151 kërkesa për azil), Algjeria (172 prej të cilave 86 kërkesa për azil), Libia, Maroku, Palestina, Afganistani, Jemeni dhe Irani me më pak shifra.

Një grup veçanërisht vulnerabël përbëhet nga fëmijët - 322 fëmijë janë ndaluar në gjysmën e parë të vitit 2018. Ndërsa gratë dhe fëmijët përbëjnë pakicën, është vënë re një rritje në këtë kategori sidomos nga marsi deri në maj (Figura 4). Shumica e grave dhe fëmijëve kanë qenë shtetas sirianë që kanë kërkuar azil.

Figura 4



Ndalimet për herë të parë janë përqendruar gjeografikisht. Nga janari deri në prill 2018, 74% e ndalimeve për herë të parë (në vijim ndalime) janë raportuar në kufirin jugor, dhe më saktësisht në pikën kufitare të Kakavijës. Përveç kësaj, 305 persona janë kapur duke dalë nga vendi (në drejtim të Malit të Zi, në zonën e Shkodrës) në periudhën tre mujore nga marsi deri në maj 2018.³ Kjo mund të lidhet me faktin se është krijuar një rrugë e re për kontrabandimin e njerëzve nga Greqia nëpërmjet Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bosnjës në Kroaci dhe në Evropën Perëndimore.⁴ Për më tepër ndalimet në territor janë rritur gjatë vitit 2018.

Pavarësisht skenarëve të sipërpërmendur, aktorët e përfshirë në ofrimin e ndihmës, shërbimeve dhe mbrojtjes do të duhet të rivlerësojnë nevojat, prioritetet dhe procedurat ekzistuese. Një ndryshim i tillë

³ Matrica e IOM për Gjurmimin e Shpërnguljes (DTM)
Përmbledhje e të dhënave dhe informacionit në dispozicion Maj 2018

⁴ <http://bih.iom.int/pbn/bosnian-police-prevent-hundreds-migrants-entering-croatia-reuters>

do të ketë pasojat e tij në parashikimet buxhetore të strukturave shtetërore, agjencie të OKB-së dhe OJQ-ve të përfshira.

Qeveria shqiptare që bashkue me UNHCR ka hartuar një raport të vecantë studimor në lidhje me përputhshmërinë e ligjit në fuqi “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit “Për të huajt” dhe zbatimin nga ana e Republikës së Shqipërisë të detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë, si ndaj akteve juridike të organizatave dhe traktateve ndërkombëtare, dhe po ashtu legjislacionit të Bashkimit Europian në fushën e azilit.

Këto gap analysis paraqiten në Aneksin që i bashkëlidhet këtij Relacioni.

Mbetet me rëndësi fakti që kuadri ligjor mbi migracionin në Shqipëri është përditësuar dhe përmirësuar me qëllim parësor respektimin e të drejtave dhe lirive të migrantëve, qofshin të rregullt apo të parregullt. Ndërkohë, zbatimi i këtij kuadri mbetet akoma problematik pasi ka mangësi sa i përket institucioneve dhe mekanizmave të nevojshme për zbatimin plotë të tyre, që duhen ngritur në vazhdimësi apo përmirësuar ato që janë sot.

Të drejtat e të huajve në legjislacionin shqiptar së pari janë sanksionuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 16 të saj ajo parashikon se: *“Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.”*

Për më tepër, sipas Raportit të Komisionit Europian për vitin 2018, mbi Kapitullin 24: Drejtësi, Liri, Siguri thuhet se: *“Shqipëria është anëtarë e Konventës së Gjenevës në 1961 dhe në 2014 miratoi ligjin e ri për azilin, i cili harmonizon kuadrin ligjor shqiptar me Acquis e BE. Gjithsesi, duke qenë që disa Direktiva të BE janë përditësuar së fundmi, disa çështje kanë përsëri nevojë të adresohen, siç janë ato që lidhen me procedurat dhe garancitë. Veçanërisht, Shqipëria i duhet tu sigurojë azilkërkuesve të drejtën e asistencës së rregull dhe shtetasit nga vendet e treta duhet të informohen mbi të drejtat e tyre dhe procedurat e azilit.”* dhe, *“Udhëzimet që rregullojnë procesin e pre-secreening, dënimin, kthimin apo ripranimin duhet ri-parë që të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Versioni i ri-parë duhet gjithashtu të përfshijë procedurat e masat mbrojtëse për të gjitha kategoritë e personave vulnerabël. Këto rregulla duhet të përputhen dhe me përmbajtjen e Ligjit të Ri për Mbrojtjen e Fëmijës dhe të përshtatet në mënyrë specifike dhe të drejtpërdrejtë me parimin e mos-kthimit dhe me të drejtën për gjuhën”*¹⁶ Ndër të tjera raporti thekson se: *“Kuadri ligjor është përgjithësisht në linjë me acquis”* dhe se: *“Shqipëria është e përgatitur në një farë niveli për zbatimin e Acquis dhe standardeve europiane në këtë fushë.”* Raporti e vlerëson si një zhvillim pozitiv me një farë progresi përmirësimitin e *“kapaciteteve institucionale në menaxhimin e kufijve, azilin dhe luftën kundër terrorizimit dhe dhunës ekstreme. Aftësia pritëse për valët e migrimit të kombinuar është rritur.”* Raporti i fundit i KE, ai i vitit 2018 vendos ndër të tjera dhe një afat për shtetin shqiptar për realizimin e strategjisë, teka thekson nevojën dhe rëndësinë që ajo ka: *“Qeverisë i mungon një strategji e plotë dhe gjithëpërfshirëse për migracionin. Strategjitë kombëtare, ajo për migracionin dhe ajo për riintegrimin e qytetarëve shqiptarë të kthyer kanë përfunduar respektivisht në vitin 2010 dhe 2015. Ministria e Brendshme ka filluar punën për një strategji të re ndërsektorale e cila duhet të miratohet në 3-mujorin e fundit të vitit 2018.”*

Kjo strategji është hartuar nga qeveria Shqiptare dhe është fazën e konsultimit publik.

Kushti themelor për qeverisjen e efektshme të migracionit në Shqipëri është të sigurohet një kuadër i qëndrueshëm politik, ligjor dhe institucional për qeverisjen e migracionit. Ky do të jetë gjithashtu objektivi kryesor i strategjisë. Një kuadër i qëndrueshëm politikash do të bëjë që politikat e migracionit të integrohen mirë në politikat sektoriale dhe ndër-sektoriale, për aq sa ato janë në përputhje me dokumentet strategjike gjithëpërfshirëse, Strategjia Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe SKZHI-në dhe procesin e anëtarësimit në BE. Përmirësimi i mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për migracionin do të jetë një objektivi kryesor për të siguruar që kuadri i politikave të bazohet në fakte. Përveç kësaj, Shqipëria do të mbetet një partner aktiv në proceset rajonale, si edhe në proceset globale për migracionin dhe për të siguruar përkthimin e angazhimit ndërkombëtarë në fushën e migracionit në veprime konkrete.

Përafrimi ligjor me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare dhe përmirësimi i kapaciteteve institucionale (si individualisht ashtu edhe nëpërmjet koordinimit të shtuar) përbëjnë një prioritet strategjik për Qeverinë Shqiptare. Realizimi i tij është thelbësor për arritjen e progresit substancial në të gjitha shtyllat e politikës së qeverisjes së migracionit. Pritet që, si rezultat, kuadri ligjor dhe institucional do të jetë në përputhje me praktikën më të mira evropiane, duke rritur aftësinë e organeve shtetërore shqiptare për të formuar partneritete efektive në qeverisjen e migracionit. Progresi në këtë fushë është gjithashtu me rëndësi thelbësore për të bërë qeverisjen e migracionit më transparente dhe të aftë për t'iu përgjigjur emergjencave në mënyrë fleksibile.

Legjislacioni ndërkombëtar mbi migrimin dhe azilin përbën në ditët tona një nga fushat më të zhvilluara të së drejtës ndërkombëtare. Kjo ka ardhur si rezultat i pranimi të fenomenit të migrimit si një fenomen i pashmangshëm, që ndodh për arsye nga më të ndryshmet por mbetet gjithsesi tipar i sjelljes njerëzore. gjendje është e ndryshme nga lidhja e zakonshme juridike mes një individi dhe shtetit të shtetësisë së tij por është e domosdoshme që të çojë, herët a vonë, gjithashtu në krijimin apo rivendosjen e kësaj lidhje, zakonisht përmes procesit të natyralizimit (bërjes shtetas në një vend për shkak të banimit të gjatë apo kushteve të lidhura me vendosjen në këtë vend).

Rregullimi ndërkombëtar i procesit të migrimit ka nisur me traktate e marrëveshje dypalëshe mes shteteve për të arritur sot në një tërësi konventash ndërkombëtare, të cilat Republika e Shqipërisë është e detyruar t'i zbatojë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj hartohet në mbështetje të neneve 16, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË

Ky projektligj është përafruar plotësisht me:

- Direktivën Nr. 2013/33/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 26 qershor 2013 për Vendosjen e Standardeve të Pranimit të Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare;
- Direktivën Nr. 2013/32/EU Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 26 qershor 2013 mbi Procedurat e Përbashkëta për Dhënien dhe Tërheqjen e Mbrojtjes Ndërkombëtare;
- Direktivën Nr. 2001/55/EC e Këshillit e datës 20 korrik 2001 mbi Standardet Minimale për Dhënien e Mbrojtjes Ndërkombëtare në rast të Fluksit Masiv të Personave të Shpërngulur dhe mbi Masat që Promovojnë një Balancë të Përpjekjeve të Shteteve Anëtare në Pranimin e Personave të Tillë dhe

Përballimin e Pasojave nga kjo;

- Direktivën Nr. 2011/95/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 13 dhjetor 2011 mbi Standardet për Kualifikim të Shtetasve të Vendeve të Treta apo Personave pa Shtetësi si Përfitues të Mbrojtjes Ndërkombëtare për një Status Unik për Refugjatët apo për Persona të Përshtatshëm për Mbrojtje Ndërkombëtare si dhe për Përmbajtjen e Mbrojtjes së dhënë.

- Direktivën Nr. 2011/51 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 majit 2011 për Ndryshimin e Direktivës së Këshillit 2003/109 / EC për Zgjerimin e Fushëveprimit të saj për Përfituesit e Mbrojtjes Ndërkombëtare;

- Direktivën Nr. 2003/86/EC e Këshillit të Bashkimit Evropian e datës 22 shtator 2003 mbi të Drejtën e Ribashkimit Familjar.

Vangjel Kosta, Viktor Gumi, Ekspertë të TLAS

3/2 Komente për PROJEKTLIGJIN “PËR SHTETËSINË”

Ministria e Brendshme ka hartuar nismën ligjore projektligjin “Për shtetësinë” dhe tekstin e tij e ka publikuar dhe kërkuar njëkohësisht mendim në institucione të ndryshme, organizata jofitimprurëse dhe organizmat ndërkombëtarë, të cilat i ka ftuar për të dhënë mendime me shkrim rreth përmbajtjes së tij.

Duke qënë se projektligji ka lidhje të drejtëpërdrejtë me misionin e UNHCH në Shqipëri dhe përbën një prej dokumenteve themelore të programit të Këshillit të Ministrave, UNHCH i kërkoi mendim të specializuar organizatës jofitimprurëse TLAS për të dhënë mendime, komente dhe propozime rreth tekstit të projektligjit.

TLAS angazhoi dy ekspertë ligjorë Vangjel Kosta dhe Viktor Gumi, të cilët bashkërisht paraqesim këtë relacion në lidhje me testin e projektligjit dhe posaçërisht në lidhje me përputhshmërinë e tij me Kushtetutën, zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe mendime rreth teknikës legjislative të përdorur në testin e projektligjit “Për shtetësinë”.

Disa konsiderata të përgjithshme

Për t’u konsideruar shtetas në bazë të veprimit të ligjit do të thotë që një individ është automatikisht i quajtur shtetas sipas kushteve të parashtruara në instrumentet ligjorë të miratuara të shtetit që lidhen me shtetësinë, ose që individit i është dhënë shtetësia me anë të një vendimi të marrë nga autoritetet kompetente. Shumica e njerëzve konsiderohen shtetas nga veprimi i ligjeve të vetëm një shteti - zakonisht ose nga ligjet e shtetit ku personi ka lindur (*jus soli*), ose ligjet e shtetit ku prindërit e personit ishin shtetas kur ka lindur personi (*jus sanguinis*).

Nuk mund të kufizohet koncepti i shtetësisë vetëm brenda kornizave ligjore të ndryshme kombëtare. Në fakt, gjithnjë e më shumë, e drejta ndërkombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe, ka ndikuar në konceptin e shtetësisë, duke ndryshuar ndonjëherë edhe në mënyrë të konsiderueshme, normativat e ndryshme kombëtare. E gjithë kjo është shumë e rëndësishme, pasi nëpërmjet shtetasve të tyre, shtetet mund të krijojnë marrëdhënie midis tyre; si përsëmbull, hyrja e një individi në territorin e një shteti tjetër dhe pasojat që rrjedhin nga kjo si mbrojtje diplomatike ose mbrojtje që çdo shtet duhet të ketë kundrejt çdo të huaji. Shtetësia është kështu një element thelbësor rregullator i marrëdhënieve ndërmjet shteteve.

Instrumente ligjore ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe janë pjesë e legjislacionit të Brendshëm, që adresojnë të drejtën për një shtetësi janë:

Neni 15 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut parashikon se çdokush ka të drejtën e një shtetësie dhe se askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij.

E drejta e çdo fëmije për të fituar një shtetësi u ngrit si çështje edhe në Paktin (Konventën) e vitit 1966 mbi të Drejtat Civile dhe Politike. Neni 24 përcakton se:

“Çdo fëmijë duhet të ketë, pa asnjë diskriminim ndaj racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë ose lindjes, të drejtën për masa të tilla mbrojtëse që kërkojnë kushtet e tij si i mitur, nga ana e familjes së tij, shoqërisë dhe shtetit.”

“Çdo fëmijë duhet të regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe duhet të ketë një emër.”

“Çdo fëmijë ka të drejtë për të fituar një shtetësi.”

Neni 26 i Paktit mbi të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 gjithashtu përcakton një masë për mos-diskriminimin e cila mund të zbatohet në një fushë shumë të gjerë, duke përfshirë legjislacionin për shtetësinë dhe mënyrën se si ai është zbatuar:

“Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë nga ligji. Në këtë drejtim, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe t’u garantojë të gjithë njerëzve mbrojtje të barabartë dhe efektive kundër diskriminimit të çdo lloji të bazuar në shkaqe të tilla si raca, ngjyra, seksi, gjuha, besimi fetar, opinioni politik ose tjetër, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose statuse të tjera.”

Konventa 1965 për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor detyron shtetet të *“garantojnë të drejtën e të gjithëve, pa dallim race, ngjyre, apo origjine kombëtare ose etnike, si të barabartë përpara ligjit,”* veçanërisht në gëzimin e disa të drejtave themelore të njeriut, përfshirë këtu të drejtën e kombësisë (neni 5).

Neni 9 i Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave të vitit 1979 adreson një shkak madhor të pashtetësisë – diskriminimi kundër grave në ligjet vendase për shtetësinë – duke deklaruar se:

“Shtetet palë duhet t’u japin grave të drejta të barabarta me burrat për të fituar, ndryshuar apo mbajtur shtetësinë e tyre. Ata duhet të sigurojnë në veçanti që as martesë me një të huaj e as ndryshimi i shtetësisë nga bashkëshorti gjatë martesës nuk duhet të ndryshojë automatikisht shtetësinë e bashkëshortes, ta lërë atë pa shtetësi ose të detyrojë mbi të shtetësinë e bashkëshortit.” “Shtetet duhet t’u japin grave të drejta të barabarta me burrat në lidhje me shtetësinë e fëmijëve të tyre”.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e vitit 1989, e cila është ratifikuar nga pothuajse çdo shtet, përmban dy nene të rëndësishme në lidhje me shtetësinë:

Neni 2 parashikon se:

“Shtetet palë duhet të respektojnë dhe garantojnë të drejtat e parashtruara në Konventë për çdo fëmijë brenda juridiksionit të tyre pa diskriminim të ndonjë lloji, pavarësisht nga raca, ngjyra, seksi, gjuha, besimi, opinioni politik ose tjetër, origjina kombëtare, etnike ose sociale, pasuria, paaftësia, lindja ose statusi tjetër i fëmijës, prindërve të tij ose të saj, ose kujdestarit të tij ose të saj ligjor”.

Neni 7 përcakton se:

“Çdo fëmijë duhet të regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe duhet të ketë të drejtën e emrit që nga lindja, të drejtën të fitojë një shtetësi dhe për sa është e mundur, të drejtën për të njohur dhe për të pasur kujdesin e prindërve të tij ose të saj.”

Neni 8 (1) parashikon se:

“Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij ose të saj, duke përfshirë shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, siç njihet nga ligji dhe pa ndërhyrje të paligjshme.”

Neni 29 i Konventës mbi Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre të vitit 1990 thekson se:

“Çdo fëmijë i një punëtori migrant ka të drejtën për një emër, për regjistrimin e lindjes dhe të një kombësie.”

Neni 18 i Konventës së vitit 2006 mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara parashikon se:

“1. Shtetet Palë njohin të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për lirinë e lëvizjes, lirinë për të zgjedhur vendbanimin e tyre dhe shtetësinë, në baza të barabarta si të tjerët, duke përfshirë edhe duke siguruar se personat me aftësi të kufizuara:

(a) Kanë të drejtë të marrin dhe ndryshojnë shtetësinë dhe nuk janë të privuar nga shtetësia e tyre në mënyrë arbitrare apo në bazë të aftësisë së kufizuar;

2. Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të regjistrohen menjëherë pas lindjes dhe kanë të drejtë që nga lindja për një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, sa më shumë të jetë e mundur, të drejtën për të njohur dhe për kujdes nga prindërit e tyre.

Konventa Evropiane për Shtetësinë, një instrument rajonal i hartuar nga Këshilli i Evropës, ka lindur nga nevoja e perceptuar për të krijuar një tekst të vetëm që të konsolidoj të gjitha zhvillimet në të drejtën e brendshme dhe ndërkombëtare përsa i përket shtetësisë që prej

kohës kur Konventa e Hagës e vitit 1930 trajtoi çështjen e konfliktit të ligjeve të shtetësisë. Në dallim nga traktatet më të hershme të miratuara në Evropë, ajo gjithashtu lejon fitimin e shtetësive të shumta për personat e martuar të shtetësive të ndryshme dhe fëmijët e tyre.

Kjo konventë gjithashtu mbulon pyetjet për fitimin, mbajtjen, humbjen dhe kthimin e shtetësisë, të drejtat procedurale, shtetësinë në kuptimin e vazhdimësisë normale të shtetit, detyrimet ushtarake dhe bashkëpunimin ndërmjet Shteteve palë. Ajo gjithashtu përmban shumë dispozita që synojnë parandalimin e krijimit të pashtetësisë. Ajo i referohet Konventës së vitit 1954 mbi Statusin e Personave pa Shtetësi për përcaktimin sipas saj të një personi pa shtetësi. Përvoja e kohëve të fundit në Evropë me hyrjen e një varg shtetesh në këtë entitet, çoi në njohjen e faktit se një numër i madh i njerëzish rrezikojnë të mbeten pa shtetësi, sepse ata mund të humbasin shtetësinë e tyre përpara se të fitojnë një tjetër.

Në një përpjekje për të shmangur pashtetësisë nëpërmjet hyrjes së një shtetit tjetër – e cila mund të ndodhë si rezultat i transferimit të territorit nga një Shtet në tjetrin, bashkimin e shteteve mes tyre, shpërbërjes së një Shteti, apo ndarjes së një pjese ose të pjesëve të territorit - Këshilli i Evropës miratoi Konventën mbi Shmangien e Pashtetësisë në raport me vazhdimësinë e Shteteve. Konventa, e cila u përshtat më 15 mars 2006, përmban rregulla specifike mbi shtetësinë në rastin e mosvazhdimësisë normale së shtetit. 22 nenet e saja ofrojnë udhëzime praktike për çështje të tilla si përgjegjësitë e Shteteve pasardhës dhe paraardhës, rregullat e dëshmisë, shmangien e pashtetësisë në lindje, dhe lehtësimi për marrjen e shtetësisë nga personat pa shtetësi.

Ka edhe disa vendime udhërrëfyese të Gjykatave ndërkombëtare evropiane në fushën e shtetësisë. Psh në vitin 210 Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian në çështjen *Janko Rottmann v. Freistaat Bayern* (C-

135/08) konkludoi se deprivimi i shtetësisë me pashtetësi si rezultat i saj të saj mund të ndodhë vetëm pas zbatimit të testit të proporcionalitetit për një masë të tillë.

Në vitin 2011 Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Genovese v. Malta* (application no. 53124/09) vendosi se shtetësia është një pjesë e identitetit personal të personit dhe si e tillë është e mbrojtur nga neni 8 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në 2014 Gjykata e Strasburgut në çështjet *Sylvie Mennesson v. France* (application no. 65192/11) dhe *Francis Labassee v. France* (application no. 65941/11) vendosi se aspektet që lidhen me identitetin social duhet të kenë pasoja për pozicionin personal të fëmijëve. Gjykata vërejti se autoritetet franceze, pavarësisht faktit se ishin në dijeni se fëmijët ishin identifikuar në SHBA si fëmijë të zotit dhe zonjës Mennesson dhe zotit e zonjës Labassee, i mohoi atyre atë status sipas ligjit francez. Gjykata theksoi se kjo kontradiktë nënvlerësoi identitetin e fëmijëve brenda shoqërisë franceze. Më tej, Gjykata konkludoi se çështjet gjyqësore franceze përjashtonin plotësisht krijimin e një marrëdhënie të realizuar si pasojë e një surrogacy të ligjshme të bërë jashtë Francës me babain e tyre biologjik. Kjo e tejkalonte hapësirën e vlerësimit që i është lënë shteteve në raport me surrogacy.

Vkitor Gumi, Vangjel Kosta, Ekspertë të TLAS

3/3 Manual për prindërit e fëmijëve interseks : “Si t’i mbështesni fëmijët tuaj interseks”

TLAS ka disa vite që po punon në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve interseks. Kjo fushë dhe ky grup është nga më të marginalizuarit për faktin se jo vetëm shoqëria është e pa informuar dhe ndërgjegjësuar për karakteristikat e këtij grupi dhe trajtimin e tij, jo vetëm shëndetësis është shpesh arbitrare me kujdesin ndaj tyre dhe njëkohësisht e pa organizuar në grup për llojin e shërbimeve që duhet të ofrojnë, jo vetëm kirurgjia planifikon operacione që jo rrallë e dëmtojnë shëndetin e fëmijës, jo vetëm këta persona në procesin e rritjes janë ...

Çfarë do të thotë Interseks?

A është vajzë apo djalë? Kjo është pyetja që dëgjohet zakonisht pas lindjes së një fëmijë. Shumë prindër mund t’i japin përgjigje lehtësisht kësaj pyetjeje. Por për një numër prindëresh kjo pyetje mund të jetë e vështirë për t’i dhënë përgjigje.

Termi interseks i referohet karakteristikave seksuale atipike të brendshme dhe/ose të jashtme anatomike, ku tiparet seksuale që konsiderohen si mashkullore apo femërore mund të shfaqen njëkohësisht dhe të ndërthuren me njëra tjetrën deri në një farë mase. Kjo dukuri tek një numër personash të porsalindur duhet të konsiderohet si ndryshim i natyrshëm dhe jo si gjendje mjekësore. Termi interseks duhet dalluar nga transeksualiteti, i cili përfshin personat që lindin me gjini plotësisht të dallueshme mashkull ose femër, por që ndihen sikur i përkasin seksit tjetër. Për këtë arsye ata janë gati t’i nënshtrohen një ndërhyrjeje kirurgjikale për të ndryshuar seksin e lindur natyror.

Për disa persona interseks, interseksualizmi shfaqet dhe është i dukshëm që në lindje, për disa shfaqet gjatë fëmijërisë, dhe për të tjerë këto karakteristika dalin në pah gjatë adoleshencës ose/dhe gjatë moshës madhore. Por ka edhe persona interseks që mund të mos e kuptojnë kurrë që janë interseks, për shkak se tiparet atipike seksuale janë minimale.

Ka shumë mënyra se si këto variacione të karakteristikave seksuale mund të kombinohen. Një fëmijë mund të lindë me një klitor më të gjatë ose me një penis me formë të ndryshme nga ajo çfarë mund të cilësohet lehtësisht i seksit mashkull. Një tjetër mund të lindë me pamje femërore, por zbulohet se mbart testikuj të brendshëm, ose anasjelltas, fëmija ka pamje të jashtme mashkullore dhe mbart vezore. Ka raste që një vajzë nuk i vijnë menstruacionet dhe një djali mund t'i fillojnë ato. Po ashtu ndodh që disa fëmijë interseks kanë bagazh hormonal të ndryshëm nga ata që janë qartësisht mashkull ose femër.

Këshilla për Prindërit

Momenti kur prinderit mësojnë se fëmija i tyre është interseks pa dyshim përbën një “surprizë” të madhe për ta. Shumica e tyre ndihet e papërgatitur për të rritur një fëmijë interseks për shkak të mungesës së theksuar të informacionit.

Nga intervistat e realizuara me prindër të fëmijëve interseks, rezulton se kryesisht ata ndihen shumë të shqetësuar për mirëqënien e fëmijës. Një pjesë e prindërve pohon se jo rrallë vetë mjekët pohojnë që fëmija interseks nuk është një fëmijë i shëndetshëm.

Duhet theksuar se një fëmijë interseks është si çdo fëmijë tjetër që kërkon kujdesin, dashurinë dhe përkushtimin prindëror, që do të gëzojë, do të qeshë dhe qajë, do t'ju bëjë të lumtuar dhe nervozojë ashtu si gjithë të tjerët. Së dyti, edhe këta fëmijë kur të rriten do të jenë të aftë dhe të gatshëm të marrin vendime për edukimin apo drejtimin e jetës së tyre. Fëmijët interseks janë thjesht një provë që tregon se sa e ndryshme është natyra njerëzore.

Ky Manual jep disa këshilla bazë dhe orientuese drejtuar prindërve në mënyrë që ata t'i japin mbështetjen e duhur fëmijës interseks, sic do të bënin për çdo fëmijë tjetër.

Përshkrim të detajuar keni në Manualin e botuar nga TLAS që mund ta gjeni në linkun: eëë.tlas.org.al/studime

Po rendisim vetëm disa nga konkluzionet:

Bazuar në informacionin e dhënë më sipër rezulton se për një numër të vogël rastesh kirurgjia mund të jetë e nevojshme, por në shumicën e rasteve të fëmijëve interseks këto kirurgji nuk janë të nevojshme, edhe kur ato prezantohen para prindërve si domosdoshmëri. Prandaj është e nevojshme të keni siguruar informacion të bollshëm para se të jepni miratimin si prind për ndërhyrje kirurgjike. Sot pjesa më e madhe e aktivistëve interseks dhe organizatave që kanë në fokus këtë kategori, rekomandojnë që këto kirurgji të realizohen vetëm me miratimin e personave interseks, në një moshë kur janë të pjekur dhe të aftë për të vendosur për trupin e tyre.

Mjekët specialistë jo rrallë keqinformojnë prindërit duke theksuar se mosrealizimi i ndërhyrjeve kirurgjikale do të sjelli probleme psikologjike tek fëmija, ngaqë gjinia është e papërcaktuar. Në fakt nuk ekziston ndonjë evidencë shkencore që të argumentojë pasojat psikologjike të fëmijës në rast mosndërhyrjeje kirurgjike. Ka të dhëna në rritje që vetë personat interseks pohojnë se kjo kirurgji nuk është e nevojshme. Madje ata që nuk i janë nënshtruar ndonjë kirurgjie kanë patur jetë të shëndetshme. Përkundrazi ata që i janë nënshtruar këtyre kirurgjive kanë vuajtur dhe dëmin psikologjik që ka ardhur si pasojë e tyre.

Si të flasësh me fëmijën tënd interseks

Edhe pse fillimisht mund të gjykoni që është më mirë apo më e lehtë që fëmijëve t'ju komunikohet në moshë madhore fakti që ata janë interseks, të zbuluarit me vonesë mund të shoqërohet me komplikacione ose gjendje “shoku” prandaj është e këshillueshme:

- Përpjekja për t'ju përgjigjur të gjitha pyetjeve që fëmija të mos gjendet i papërgatitur;
- Nuk është nevoja t'i shpjegoni që në fillim fëmijës termat biologjike, por mundet gradualisht të përdorni shprehje si “jo të gjitha vajzat apo djemtë janë njëlloj”;

- Të përgatisni fëmijën për sfida dhe vështirësi që mund të ndeshen gjatë rritjes dhe që do t'i kaloni bashkë të gjitha vështirësitë;
- Mbështesni dhe inkurajoni fëmijën gjatë periudhave delikate, duke theksuar se çdo person ballafaqohet me sfida;
- Të parashikoni që një ditë fëmija do rritet dhe duhet të bëhet i pavarur, prandaj ka nevojë të dijë të gjitha faktet rreth trupit të vetnë mënyrë që të marrë një vendim në të ardhmen.

Si të përballojmë stigmën shoqërore

Prindërit e fëmijëve interseks e vrasin mëndjen se si do të komunikojnë me të tjerët. Bëni kujdes! Në asnjë moment mos lejoni që fëmija të mendojë se kjo duhet të përbëjë sekret. Nëse fëmija juaj mendon se të qenit intersex duhet mbajtur e fshehtë atëhere ata do të kujtojnë që ka diçka të gabuar tek ata. Lëreni fëmijën të njihet me të gjitha faktet rreth trupit në mënyrë pozitive, dhe se edhe pse të ndryshëm mund të jenë të shëndetshëm, të lumtur pa u kategorizuar detyrimisht si mashkull apo femër.

Përpikuni të shpjegoni se të qenit interseks nuk është e pazakonshme, në mënyrë që të evitoni ndjesitë e izolimit. Nëse fëmija dëshiron të dalë hapur si interseks, mbështeteni këtë vendim, por edhe nëse nuk dëshiron të dalë hapur, përsëri mbështeteni. Mos e prezumoni identitetin gjinor apo orientimin seksual të fëmijës suaj interseks. Sikurse të gjithë fëmijët, identiteti i tyre gjinor apo/dhe orientimi seksual mund të jetë shumë ndryshe nga çfarë ju prisni.

Shumë individë nuk janë në dijeni të diversitetit që karakterizon shoqërinë tonë, ndaj personat interseks kanë qenë të padukshëm për një kohë të gjatë. Është shumë e rëndësishme të investoni në rritjen e vetë-besimit të personave interseks dhe në dashurinë prindërore e mbështetjen.

Vendim-marrja

Edhe pse në pamje të parë duket sikur çdo ndërhyrje e hershme tek fëmijët interseks është vendimi më i mirë, eksperiencia tregon se e kundërta është e vërtetë. Këshillohet që të prisni derisa fëmija të arrijë moshën që të marri vet vendimin. Fëmijët nisin të shprehin mendimet e tyre dhe të ndërgjegjësohen rreth moshës 2 vjeç ndaj rekomandohet përfshija e tyre në çdo vendim. Sigurohuni që mjekët të mos ju ngarkojnë me detaje e informacione të një natyre teknike. Ata mund të jenë ekspertët në fushën e mjekësisë por në fund Ju dhe fëmija juaj duhet të jeni sa më të sqaruar para vendim-marrjes. Lëreni kirurgjinë si opsionin e fundit. Informohuni për rreziqet e mundshme të ndërhyrjeve kirurgjikale. Fëmija ka të drejtë të njihet me të gjitha të dhënat mjekësore të regjistruara për të. Përfshini fëmijën në takimet me mjekët. Inkurajoni fëmijët që të pyesin doktorët sa më shumë për çdo paqartësi që mund të kenë.

Ju si prindër duhet të jeni të pranishëm në çdo ekzaminim mjekësor që realizohet për fëmijën interseks, derisa ky i fundit të arrijë moshën e pjekurisë.

Si të flasësh me të tjerët për fëmijën tuaj interseks

Fëmijët nisin të ndërgjegjësohen dhe të shprehin mendimet e tyre rreth moshës 2 vjeç, ndaj përfshijeni fëmijën tuaj në vendimarrje sa më shpejt që të jetë e mundur. Pyeteni fëmijën se si ndihet për faktin e të treguarit të tjerëve që janë interseks. Rikujtoji fëmijës që nuk ka asgjë për të cilën të ndihen të turpëruar, por nga ana tjetër duhet t'i shpjegoni se disa persona mund të kenë reagime të çuditshme ndaj interseksualizmit për shkak të mungesës së informacionit. Kur flisni me të tjerët për fëmijën tuaj interseks, sigurohuni që ta bëni me ton që mos të tingëllojë si sekret apo si diçka për të cilën turpëroheni. Edhe pse mund të merrni reagime negative apo të sikletshme, duhet të tregoni se nuk ka

asgjë të gabuar, vetëm në këtë mënyrë njerëzit mund të ndryshojnë perceptimet ose mungesën e informacionit për këtë subjekt. Sa më të hapur dhe krenarë të jenë prindërit e fëmijëve interseks, aq më shumë ndërgjegjësim do të ketë në shoqëritë tona. *Tregoni durim*

Për shumicën e personave termi interseks mund të jetë i ri dhe jo shumë i kuptueshëm në fillim. Merrni kohën e duhur për të bërë shpjegimet e nevojshme. Tregojuni se të qenurit interseks është plotësisht normale. Bëhuni gati për reagimet e sikletshme dhe negative, duke ju përgjigjur me qetësi dhe pozitivitet. Shumica e këtyre reagimeve vjen si pasojë e mungesës së informacionit rreth interseksualizmit dhe stigmës shoqërore që e ka konsideruar si anomali ndër vite. Përdorni terma të thjeshtë dhe terminologji jo të vështirë për tu kuptuar.

Nëse keni fëmijë të tjerë, shpjegojuni se çfarë do të thotë termi interseks. Përmes shpjegimeve të diversitetit dhe ndryshimeve, mund t'i prezantoni fëmijëve të tjerë rreth interseksualizmit. Këshillojini familjarët e tjerë që të shfaqin sa më shumë mbështetje për personin interseks në familje.

Pyetje që të tjerët bëjnë për fëmijën tuaj interseks

A është foshnja juaj djalë apo vajzë?

Mënyra se si do ti përgjigjeni kësaj pyetjeje varet nga mënyra se si do ta rrisni fëmijën tuaj. Nëse po e rrisni si vajzë apo djalë, atëherë mund t'i jepni lehtësisht përgjigje pyetjes. Nëse nuk jeni të sigurtë për identitetin gjinor të fëmijës, mund të shprehni se po e rrisni fëmijën në një mënyrë që t'ja lini në dorë fëmijës të zgjedhi vetë identitetin me të cilin identifikohet.

Çfarë shkoi gabim?

Jo, asgjë nuk shkoi gabim! Rreth 1.7% e lindjeve në botë kanë karakteristika seksuale të ndryshme nga ato lehtësisht të cilësuar si vajzë apo djalë. Problemi i vetëm është që nuk është folur mjaftueshëm në shoqëritë tona për këtë gjë.

Pra fëmija juaj është hermafrodit?

Jo! Hermafroditët gëzojnë plotësisht organet femërore si dhe atë mashkullore, dhe kjo është e pamundur tek qeniet njerëzore. Ndërkohë personat interseksual kanë variacione në karakteristikat seksuale që nuk përputhen me normat e trupave femërore apo mashkullore.

A përbën interseksualizmi një çrregullim?

Interseksualizmi thjeshtë përbën diversitet në trupat njerëzorë, sikurse variacioni në gjatësi apo ngjyrën e flokut.

Si duken gjenitalet e bebes suaj interseks?

Një këshillë ndaj personave që bëjnë këtë pyetje: A nuk ju duket një pyetje jo fort e hijshme për tu bërë? Edhe fëmija më i vogël ka të drejtën e privatësisë.

A duhet ta operoni fëmijën tuaj interseks?

Shumë persona interseks do të rriten pa pasur nevojën e ndonjë ndërhyrjeje kirurgjikale. E vetmja gjë që duhet, është mirëkuptim dhe pranim shoqëror, pasi personat interseksual ende shihen si të ndryshëm dhe kjo sjell episode bullizmi dhe diskriminimi.

Çfarë orientimi seksual kanë personat interseks?

Nuk ka asnjë ndërlidhje midis karakteristikave seksuale dhe orientimit seksual, ndaj personat interseks mund të jenë lezbike, gej, biseksualë ose çdo orientim tjetër seksual.

Cili është identiteti gjinor i personave interseks?

Shumë persona interseksualë mund të identifikohen si vajzë apo djalë, në përputhje me gjininë që i është përcaktuar në lindje. Ndonjëherë këta persona e kuptojnë teksa rriten, që identifikohen me një identitet tjetër gjinor, të ndryshëm nga ai që i përcaktohet në lindje. Shumë të tjerë mund të vendosin të kenë identitet jo binar (non-binary person).

TLAS, 2019

1. Histori e Vërtetë: Njohje e amësisë për tre fëmijë

NB është një qytetare që i përket komunitetit Rome në qytetin e Lezhës dhe po t'i referohesh statusit civil ajo është beqare dhe pa fëmijë. Por NB edhe pse e pa martuar ligjerisht, ka lindur tre fëmijë nga bashkëjetesa me FZ, i cili nga ana e tij është i martuar me shtetasen MZ. Të tre fëmijët të gjinisë mashkull kanë lindur respektivisht në vitet 2004, 2008 dhe 2014, pra janë sot 16, 12 dhe 6 vjec. Që të tre fëmijët janë regjistruar në gjendjen civile në fletën familjare të babait biologjik FZ, dhe me nënë MZ, që është emri e gruas së ligjshme të bashkëjetuesit. Në këtë situatë NB, nuk "ekziston" dhe nuk figuron në gjendjen civile si nënë me fëmijë. Nga ana tjetër gjatë gjithë kohës ajo realisht kujdeset për të tre fëmijët e saj duke mos përfituar asnjë ndihmë financiare ekonomike dhe as nga programe të tjera sociale që favorizojnë nënat kryefamiljare; Kush e pengon NB të gëzojë statusin e nënës kryefamiljare për t'u kualifikuar për ndihmë ekonomike por edhe për t'u punësuar me përparësi nga organet përkatëse?

Ajo sot gëzon statusin e nënës de facto, por nuk njihet de jure ose ligjerisht si nënë e tre fëmijëve të saj. Që të realizohet kjo duhet të kundërshtohet amësia de jure e MZ e cila mund të realizohet vetëm përmes procedurave gjyqësore. A është përpjekur NB të zgjidh këtë hall të madh? Ajo ka bërë prej vitesh disa përpjekje për t'u njohur si nënë, për t'i kaluar fëmijët e saj në fletën e saj familjare në gjendjen civile, por shumë vite kanë kaluar dhe ajo ka dështuar me sukses!

Punonjësit e gjendjes civile e drejtonin në gjykatë sepse me të drejtë njohja e amësisë realizohet vetëm përmes një vendimi të marrë nga gjykimi i kësaj çështjeje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Atëherë NB tentoi të bisedonte me një avokat privat dhe aty mësoi se përveç pagesës jo të vogël për kushtet ekonomike të NB për punën që do të bënte avokati për hartimin e kërkesë padisë dhe përfaqësimin në seancat gjyqësore, asaj i shtoheshin edhe shpenzime të tjera si ato administrative, noterizimet, ato gjyqësore, por mbi të gjitha shpenzimet për kryerjen e analizës shkencore të testit të amësisë (ADN) për të tre fëmijët që sigurisht ishin kosto e papërballueshme për të. Kështu që NB dhe bashkëjetuesi i saj FZ duke mos parë asnjë rrugë zgjidhje, për vite me rradhë pranuan të jetonin pa gëzuar të drejtat themelore dhe në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijëve të tyre.

Një ditë më në fund falë zyrës së shërbimit ligjor falas në qytetin e Lezhës ky rast kaq delikat, kompleks, i kushtueshëm dhe kritik u prezantua te avokati i TLAS dhe filloi puna në grup për të trajtuar hap pas hapi disa çështje të lidhura pazgjidhmerisht me njëra tjetrën. Së pari u hartua dhe depozitua një kërkesë në

Gjykatë për kundërshtimin e amësisë de jure dhe dhe njohjen amësisë biologjike. Së dyti u paraqit një kërkesë po në gjykatë për zgjidhjen e martesës së bashkëjetuesit FZ nga MZ dhe u vazhdua me procedurat administrative për shpalljen e martesës së tij me NB. **Më në fund mbas 16 vjetësh të tre fëmijët, nëna biologjike dhe babai i tyre u bashkuan si familje në vitin 2019.**

Nëse nuk do t'ju opfrohej ndihma juridike falas, kjo familje nuk do të bashkohej kurrë dhe NB edhe sot e kësaj dite do të figuronte ligjërisht pa tre fëmijët e saj. Ndihma Juridike e garantuar nga shteti është e domosdoshmëri për këtë kategori prindërisht dhe fëmijësh të cilët nuk janë në gjendje të ndjekin rrugët ligjore dhe si rezultat jeta e tyre komplikohet në mënyrë progresive duke çënuar të drejtat themelore dhe interesin më të lartë të fëmijëve.

Rudina Brari

Avokate e TLAS

2. Histori e vërtetë: Fëmijë i paregjistruar për shkak të lidhjes jashtmartesore

FÇ, qytetare e komunitetit Rom, nga bashkëjetese me AK, ka sjellë në jetë në Mars 2018, vajzën e saj, lindur në maternitetin e Gjirokastrës. Meqenëse fëmija ka ardhur në jetë nga një lidhje jashtë martesore, edhe pse pengesa ligjore për regjistrimin e fëmijës nuk ka patur, ajo ka mbetur e paregjistruar në gjendjen civile për shkak të nënës e cila nuk mori përgjegjësinë ndaj foshnjës së saj. Ajo justifikoi veprimin e mos regjistrimit duke pretenduar që do ta bëjë mbasi të zgjidhte martesën e saj nga bashkshorti “de jure”. Por ajo jo vetëm nuk e bëri zgjidhjen e martesës, përkundrazi ndërroi vendimin e largimit nga qyteti në drejtim të panjohur.

Në fillim për fëmijën u kujdes gjyshja nga nëna, pastaj për më shumë se 9 muaj u kujdes gjyshja nga babai AK. Kjo e fundit bazuar në situatën shëndetësore dhe finaciare e pa të arsyshme që të dërgojë një kërkesë me shkrim në Drejtorinë përkatëse të Shërbimit Social ku shprehet se për arsye social-ekonomike e ka të pamundur të kujdeset për mbesën e saj, e cila është lënë pa kujdes prindëror si nga nëna, që e ka braktisur duke u larguar në drejtim të paditur edhe nga babai pretendues i fëmijës që është dënuar me 7-vjet heqje lirie.

Në këto kushte Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve Gjirokastrë, mbështetur në ligj ka detyrimin të marri masat mbrojtëse ndaj fëmijës dhe i drejtohet gjykatës për vendosjen në kujdestari të përkohshme të fëmijës së braktisur nga prindërit (“Bebe”). Kërkesa pranohet nga gjykata dhe fëmija vendoset në kujdesin e Shtëpisë së Fëmijës Vatra e Ngrohtë –Gjirokastrë. ***Por vajza e vogël, tashme me shume se 12 muaj, është ende e paregjistruar në gjendjen civile.***

Prandaj pas vendosjes së fëmijës nën kujdestarinë e shtëpisë së fëmijës, Agjensia Shtetërore për të Drejtat & Mbrojtjen e Fëmijës, ASHDMF, e referon rastin pranë shërbimit ligjor falas Tiranë, TLAS, për realizimin e procedurave për njohjen e faktit të lindjes ose identitetit të fëmijës. Menjëherë pas referimit të rastit, avokatët e TLAS në bashkëpunim me Zyrën e Gjendjes Civile Krastë, Tepelenë; Bashkinë Gjirokastrë dhe Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, vendosën të zgjidhnin çështjen duke ndjekur këto hapa: Regjistrimin e fëmijës me emrin e nënës dhe me atësi e prezumuar për shkak të lidhjes martesore që nëna kishte aktualisht, edhe pse babai i prezumuar nuk pranonte ta regjistronte. Sigurisht u bë një punë e kujdeshme sqaruese me këtë baba, duke i premtuar që mbas këtij veprimi do të hapej një çështje gjyqësore për kundërshtim atësie të prezumuar me shpenzimet e mbuluara nga TLAS. Dhe kështu ndodhi, pas regjistrimit të fëmijës u bë i mundur fillimi i procesit gjyqësor për kundërshtimin e atësisë së prezumuar,

dhe babai biologjik i fëmijës, edhe pse në kushtet e privimit të lirisë, e njohu e atesinë në menyrë vullnetare para nëpunësit të gjendjes civile.

Nuk është e thjeshtë të trajtosh raste të tilla, të cilat kërkojnë: përkushtim dhe asistim ligjor profesional të plotë deri në kalimin e të gjitha pengesave që diktojnë zgjidhjen finale; bashkëpunim dhe komunikimin njerzor e ndërgjegjësues, me durim me familjarët e disa palëve të përfshira në këto lloj procesesh por edhe me strukturat lokale që kanë rol në shërbimet që duhet të ofrojnë; shpenzime të konsiderueshme udhëtimi, administrative, noteriale, shkencore e vecanërisht kur një proces gjyqësor zgjat disa seanca.

Rudina Brari,

Avokate e TLAS

Histori e vërtetë: Fëmijë pa kujdestar ligjor

Nga pervoja dhe praktika me rastet e fëmijëve pa kujdestari TLAS evidenton se ata janë në numër të konsiderueshëm⁵ për arsye nga më të ndryshmet: së pari mbeten pa kujdestar ligjor sepse i përkasin grupeve më vulnerabël të shoqërisë që nuk mund të përballojnë procedurat e nevojshme dhe shpenzimet gjyqësore për të marrë vendimin e gjykatës për këtë qëllim; së dyti sepse ende është në shkallë të konsiderueshme indiferentizmi i komunitetit, i shkollës dhe vecanërisht i strukturave të mbrojtjes sociale lokale që kanë detyrimin të referojnë dhe menaxhojnë rastin deri në zgjidhje; së treti faktorët që shkaktojnë mungesën e kujdestarisë ligjore të fëmijëve janë bërë të pashmangshëm sepse bazohen në lirinë e lëvizjes së qytetarëve, në fenomene si migracioni, bashkëjetesa e lirë, braktisja dhe vecanërisht ata që lidhen me kushtet social ekonomike të familjeve.

Rasti që po prezantojmë më poshtë është një nga tipologjitë sa e vëçantë aq edhe me ngjashmëri kur në fund të fundit fëmija pavarësisht shkaqeve mbetet pa kujdestar ligjor. Për të gjithë ata në të njëjtën situatë me të drejtë të vijnë në mendje pyetjet: A gëzon fëmija pa kujdestar të drejtën e rritjes me dashuri në një mjedis familjar të qëndrueshëm; të drejtën e mbrojtjes nga abuzimi fizik, psikologjik apo seksual; të drejtën e identitetit, të arsimit, të shëndetit, të ushqimit, të veshjes, të mos shfrytëzimit për punë, të mos diskriminimit dhe mos neglizhimit?

Çështja e fëmijës AÇ u referua pranë zyrës sonë nga punonjësi i Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.6, Tiranë në fillim të vitit 2019. Ata bënë të ditur që kishin regjistruar një fëmijë të gjinisë femërore, që kishte lindur që në datë **01.02.2016** në burgun Edirne- Turqi dhe që kishte nevojë për kujdestari. Si kishte ndodhur?

Në datë 27.05.2015 prindërit e fëmijës të dy udhëtonin me autobus nga Greqia në Turqi, por në pikën kufitare të kalimit në Ipsala ata të dy u arrestuan pasi në trupin e tyre ju gjetën lëndë narkotike dhe në kohën e arrestimit nëna e fëmijës, AZ, ishte shtatëzanë. Në datë 13.04.2016 gjykata turke jep vendimin përfundimtar për prindërit e fëmijës, të cilët u dënuan me 25 vite burg secili. Vitin e parë të jetës fëmija e kaloi në burg së bashku me nënën e saj dhe një vit më vonë, prindërit e babait të fëmijës, shkuan në

⁵ Vetëm gjatë vitit 2019 janë përfshirë përmes procedurave gjyqësore raste të kujdestarisë ligjore për fëmijë nga familje vulnerabël nga gjithë territori i vendit

burgun ku po vuanin dënimin dhe morrën fëmijën bebe dhe kthehen në Shqipëri. Që nga smuaji Mars i vitit 2017 fëmija jeton me gjyshërit në Shqipëri të cilët ushtronin de facto kujdestarinë mbi fëmijën, por pa pasur të drejta ligjore ndaj mbesës së tyre një vjecare.

TLAS e analizoi me kujdes rastin dhe arriti në përfundimin që në mungesë të prindërve, të cilët do ta kalonin një opjesë të madhe të jetës së tyre në kushtet e izolimit në institucionin e vuajtjes së dënimit në Turqi, në kushtet që fëmijëria e vajzës së vogël nuk do të shoqërohej me kujdesin e prindërve biologjikë, e vetmja rrugë zgjidhje ishte kërkimi i kujdestarisë ligjore të vajzës nga gjyshërit, nga ana e babait, të cilët ishin dakord ta merrnin këtë përgjegjësi por dhe në të njëjtën kohë e plotësonin kriterin e moshës për të qënë kujdestar të fëmijës. Mbasi u mblodhën dokumentat e nevojshme për hapjen e procedurave gjyqësore të kujdestarisë, duke qenë se prindërit e fëmijës ishin në kushtet e pamundësisë për të ushtruar përgjegjësinë prindërore (në bazë të Nenit 263 i Kodit të Familjes përcakton rastet, kur një fëmijë i mitur vendoset në kujdestari dhe konkretisht: “kur prindërit e të miturit janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë e tyre prindërore, për shkak..... të pranuar nga gjykata” dhe Ligji nr. 9062, datë 8.05.2003, “Kodi i Ri i Familjes” në një kapitull të veçantë rregullon institucionin e kujdestarisë, duke përcaktuar përfundimisht, Gjykatën si organin e vetëm kompetent për rastet e parashikuara në të). Procedura përfundoi me sukses, vajza e moshës tre vjece u vendos në kujdestarinë e gjyshërve të cilët përfaqësojnë atë në të gjitha institucionet, përmbushin nevojat e fëmijës, i sigurojnë asaj një ambient të përshtatshëm për mirërritje duke përfutur edhe pagesën që programi i kujdestarisë i ofron.

Mersida Male

Avokate e TLAS

Histori e vërtetë: Fëmijë i moshës 12 vjec i paregjistruar në gjendjen civile?!

Që në momentin e parë të prezantimit të rastit avokatët e TLAS pyesin veten përse, kush ka qënë shkak që fëmija ka ngelur pa identitet dhe pa shtetësi? A është çështje që mund të zgjidhet në rrugë administrative, apo me rrugë gjyqësore? A ka nevojë për analizën e ADN? Sepse dihet që kostot e rastit janë shumë më të mëdha nëse analiza shkencore⁶ është domosdoshmëri.

Prindërit e fëmijës VM u referuan në zyrën e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, TLAS, nga punonjësja e Gjendjes Civile Gradisht, rrethi i Lushnjes. Sa shume ishin munduar prindërit e fëmijës për të regjistruar vajzën e tyre që kishte lindur që në 2007. kishin trokitur në çdo institucion, madje duke e bërë rastin dhe public në media, por përpjekjet rezultuan të pasuksesshme dhe V.M vazhdonte të ishte e pa regjistruar, pavarësisht se kishte lindur që në vitin 2007, në kohën kur punonin si emigrant të paligjshëm në Athinë, Greqi. .

Vajza lindi në maternitet në Athinë, dhe sipas ligjit Grek, lindja e bebit raportohet automatikisht në gjendjen civile të lagjes përkatëse, ku edhe regjistrohet akti i lindjes. Prindërit shqiptarë janë të painformuar për të vepruar sipas ligjit grek, kështu që kur paraqiten në zyrën e gjendjes civile ata mund të tërheqin certifikatën e lindjes, por pa emër të fëmijës. Ata mund të deklaronin emrin e fëmijës përpara punonjësit të gjendjes civile, Athinë, por nuk mund ta bënin sepse ishin të paligjshëm dhe kishin detyrimin të shlyenin pagesën e shërbimit shëndetësor të maternitetit, pagesë që është detyrim

⁶ Gajtë vitit 2019 Avokatët e TLAS kanë zgjidhur përmes procedurave gjyqësore 74 raste të regjistrimit të lindjeve dhe për 47 prej tyre gjykatësi ka kërkuar të bëhet analiza e ADN. Këto kosto janë mbështetur nga donatorë si UNHCR, Sëiss Embassy, Partners Albania, UNDP, World Vision, etj.

për cdo qytetar jpa dokumenta qëndrimi në Greqi. Kjo ishte arsyeja që mbas tre muajve ata bashkë me vajzën nga shteti Grek dhe kthehen në Shqipëri, në vendin e tyre të lindjes, në komunën Gradisht, Lushnje. Që në 2007 filluan përpjekjet për të regjistruar vajzën në gjendjen civile, Gradisht, por dokumenti që ata kishin ishte i paplotë, mungonte emri i fëmijës dhe vula apostile. Rruga për të regjistruar fëmijën ishte të udhëtonin për në Greqi, të paraqiteshin përpara punonjësit të gjendjes civile në Athinë dhe të deklaronin emrin e fëmijës, pas kësaj të shkonin për të marrë vulën apostile në autoritetin përgjegjës.

Si të dëbuar prinderit nuk kishin më të drejtë të hynin në territorin grek. Nga ana tjetër kostot e udhëtimit, hotelit, shpenzimet shëndetsësore që i detyroheshin shtetit grek, përkthimet e noterimit, etj ishin të papërballueshme për familjen. Vetëm kur Shërbimi Ligjor Falas Tiranë vendosi një tabelë në cdo zyrë të gjendjes civile në Shqipëri, ku theksohej që kush ka nevojë të regjistrojë fëmijën të paraqitet në këtë adresë dhe të kontaktojë në këtë numër telefoni⁷, u kujtua punonjësi i gjendjes civile të njoftojë dhe drejtojë qytetarin në zyrën e TLAS. Për punonjësit e zyrave të gjendjes civile kudo që janë është dhënë informacioni që rastet e fëmijëve apo personave pa shtetësi, që janë në kushtet e pamundësis për të mbuluar shpenzimet e avokatit privat, ato gjyqësore e administrative të rekomandohen drejtpërdrejtë në shërbimin ligjor falas. Konkretisht për këtë rast TLAS vendosi që një nga avokatët e zyrës të të pajisej me prokurë nga prindërit, ku theksohej që mund të përfaqësonte ata për të tërhequr certifikatën origjinale në zyrën e Gjendjes Civile Athine, dhe të paraqitej në Minsitrinë së Punëve të Jashtme në Athinë për të vënë vulën apostile. Pra ky rast mund të ndiqej në rrugë administrative, rrugë e cila ka kosto financiare jo të vogla sepse përfshin kostot e udhëtimit, akomodimit, dhe më tej në Shqipëri kosto të tjera noteriale dhe të përkthimit duke e kompletuar dokumentin e lindjes në përputhje me legjislacionin shqiptar, për t'u ekzekutuar nga punonjësit e gjendjes civile.

Vajza ishte 12 vjec në momentin kur u regjistrua në gjendjen civile. E drejta e identitetit është një e drejtë themelore dhe bazë për të gëzuar të gjitha të drejtat që burojnë nga ajo: e drejta për jetën, për shëndetin, për arsimin, për punësimin, për të votuar, për të mos u diskriminuar dhe abuzuar, shrytëzuar e shumë e shumë të drejta të tjera.

Vilma Gjeci,

Paralegal/psikologe e TLAS

Monitorimi i zbatimit të ndryshimeve të Ligjit të Gjendjes Civile në përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë në Athinë, Selanik dhe Janinë.

Që në vitin 2018 një grup ekspertësh të TLAS me mbështetjen e UNHCR, punuan për draftimin e disa ndryshimeve të rëndësishme të ligjit “ Mbi Gjendjen Civile” për regjistrimin e lindjeve të fëmijëve, të cilat u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në tetor 2018. Në vazhdim grupi i punës draftoi 6 akte nënligjore në zbatim të ndryshimeve që pësoi ligji për këtë qëllim. Aktet u miratuan njëri pas tjetrit duke filluar nga Marsi i 2019 dhe ishin një sfidë për ata të përket elementëve të rinjë që ofronin si për organet administrative ashtu edhe për ato gjyqësore lidhur me regjistrimin e lindjeve të fëmijëve dhe jo vetëm, përfshirë dhe persona të tjerë që identifikohen si pashtetësi. TLAS gjatë vitit 2019 i kushtoi një vëmendje të vecantë monitorimit në praktikë të zbatimit të këtyre ndryshimeve e akteve të reja nga aktorët që ligji i ngarkon me përgjegjësi përkatëse si Gjykatat, Zyrat e Gjendjes Civile, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, partnerët

⁷ Shikoni tabelën bashkëngjitur e cila është vendosur pranë bashkive dhe njësive administrative në të gjithë vendin;

lokalë shtetëror, organizatat e shoqërisë civile që ndeshen dhe identifikojnë raste të fëmijëve të paregjistruar si dhe përfaqësitë diplomatike shqiptare nëpër botë.

Stafi i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, TLAS, ka monitoruar dhe ofruar shërbime direkte gjatë vitit 2019 përmes ndihmë juridike falas për 530 raste/ fëmijë të paregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile të moshave nga 1 deri në 18 vjec. Fëmijët e paregjistruar i përkasin kryesisht familjeve të varfëra dhe në pamundësi ekonomike për të përballuar kostot e avokatit, të ekspertizës apo të tarifave të tjera administrative të nevojshme. Tabela më poshtë jep numrin e rastve të fëmijëve të paregjistruar, të monitoruar dhe shërbyer nga TLAS, ku kanë lindur fëmijët dhe rruga e ndjekur për zgjidhjen e tyre:

Lloji i rasteve / fëmijëve të paregjistruar	Zgjidhur me rrugë administrative	Zgjidhur me rrugë gjyqësore	Total
Fëmijë të lindur brenda Shqipërisë	230	26	256
Fëmijë të lindur jashtë Shqipërisë	233	41	274
Total	463	67	530

Sic shihet edhe në tabelen e mësipërme, një numër i konsiderueshëm fëmijësh të paregjistruar kanë lindur jashtë kufijve të vendit dhe pjesën më të madhe e zenë ata që kanë lindur në shtetin Grek. Prandaj dhe u pa me shume interes të monitoroheshin tre konsullatat tona në Greqi, ajo e Athinës, e Selanikut dhe e Janinës. Prandaj tre avokatë të TLAS, në zbatim edhe të një mikroprojekti të dedikuar vetëm për këtë monitorim, financuar nga European Network on Statelessness, ENS, dhe UNHCR udhëtuan respektivisht në muajin Maj dhe Dhjetor 2019 posaçërisht drejt Greqisë për të trajnuar dhe parë si po zbatohen ndryshimet e legjislacionit për regjistrimin e lindjeve nga konsullatat e mësipërme. Vizitat shërbyen për informim, trajnim dhe monitorim të pengesave apo vështirësive që stafet e konsullatave kanë hasur gjatë zbatimit të ndryshimeve në legjislacionin e “Mbi Gjendjen Civile” referuar regjistrimit të lindjeve.

Seancat trajnuuese me stafet përkatëse në të tre konsullatat u përqëndruan specifikisht në :

1. Mungesa e njohurive për ndryshimet e bëra në nenin 41/3 të Ligjit Nr. 10129, Datë 11.05.2009 "Për Regjistrimin Civil", i cili thotë se: "Regjistrimi i lindjes së fëmijëve të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tek shtetasit shqiptarë me qëndrim të përhershëm në Shqipëri, do të kryhet nga shërbimi i regjistrimit civil të këtij vendi. Kur është e pamundur, përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë shqiptarë në vendin e lindjes së fëmijës regjistrojnë lindjen e fëmijës". Ky nen u jep autoriteteve konsullore fuqinë për të ruajtur dhe mbajtur aktet e lindjes së një fëmije të lindur në territorin e tyre. Ata u trajnuan në teori dhe praktikë se si të regjistroheshin 7 (shtatë) akte lindjeje të fëmijëve të identifikuar nga TLAS.
2. Ndryshimin e parashikuar në nenin 27/3 të të njëjtit ligj që thotë: "Aktet e lindjes, martesës dhe vdekjes për shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të mbajtur nga gjendja civile e shteteve të huaja ose nga përfaqësitë tona diplomatike ose zyrtar konsullore atje, i përcillen zyrtare përkatëse të gjendjes civile për procedime të mëtejshme, qoftë nga personi në fjalë ose përmes Ministrisë së Evropës dhe Punët të Jashtme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile".

Udhëzimi u dha nga trajnerët se si të procedohen dhe referohen saktë këto akte tek autoritetet shqiptare në Shqipëri. Konsujt kanë detyrimin të marrin certifikatat e lindjes së azhurnuar (brenda 3 muajve

nga data e lëshuar sipas akteve ligjore Greke), t'i vulosin ato, dhe t'i paraqesin këto dokumente përmes Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile me kërkesën e oficerëve konsullorë drejtuar zyrave të shtetit grek dhe prefekturës. Legjislacioni Grek ka bërë të mundur nxjerrjen e akteve të lindjes së fëmijëve pa emër dhe vulosjen e tyre në të njëjtën kohë, një veprim që nuk mund të realizohej më parë.

3. Zbatimi i nenit 40/3 të ndryshuar, për deklaratën e lindjes, thotë: "Nëse personat e caktuar në paragrafin 1 nuk deklarojnë lindjen e fëmijës brenda 60 ditësh, lindja deklarohet nga subjektet e parashikuara në paragrafin 2 ". Rregullat e detajuara për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me aktin nënligjor të ministrit përgjegjës për regjistrimin civil Nr 286, datë 11.03.2019". Trajnerët sqaruan se bazuar në këto ndryshime, jo vetëm prindërit, por edhe përfaqësuesit me autorizim ligjor janë legjitimuar të bëjnë deklaratën e lindjes së fëmijëve në konsullatë.
4. Zbatimi i nenit 45/3 i cili thotë: "Nëse certifikata e lindjes e lëshuar jashtë vendit është e paplotë, kolona e emrit të fëmijës, ajo do të plotësohet në përputhje me procedurën administrative, të përcaktuar me aktin nënligjor të Ministri përgjegjës për regjistrimin civil. Nr 286, datë 11.03.2019". Ky udhëzim përkatës për deklarimin e emrit të fëmijës para nëpunësve civilë në këtë rast të konsujve ishte shumë i rëndësishëm sepse kjo procedurë bën të mundur mbajtjen e plotë të akteve.

Për më tepër, ekspertët e TLAS ofruan gjithashtu asistencë teknike për aksesin në Regjistrin Kombëtar për të identifikuar problemet me regjistrime të shumta të shtetasve shqiptarë dhe për të mundësuar qasjen e duhur mbi historikun e të dhënave.

Denada Selimi

Këshilltare e Programit TLAS

Forcimi i Bashkëpunimit të TLAS me Grupet Teknike Ndërsektoriale, GTN

Mbas më shumë se 21 vjet praktikë për ofrimin e ndihmës juridike falas për individët në nevojë në shkallë vendi, duket që numri i bashkëpunorëve të TLAS është rritur dhe bërë më efektiv lidhur me zgjerimin e aksesit në drejtësi.

Gjatë vitit 2019, bashkëpunimi me grupet teknike ndërsektoriale ka qënë shumë konkret. Avokatët dhe paraligjorët e TLAS janë ftuar dhe kanë marrë pjesë në 20 takime të grupeve teknike ose të GTN' ve. Pse GTN e fton përfaqësuesin e TLAS në këto takime? Së pari ftesa për pjesëmarrje të përfaqësuesve të Shërbimit Ligjor Falas në takimet e ndryshme të GTN've konsiderohet si një reagim pozitiv, konkret dhe shumë i rëndësishëm që strukturat lokale të mbrojtjes së fëmijëve po bëjnë në zbatim të Ligjit për të Drejtat e Mbrojtjes së Fëmijës. Prezenca e TLAS bën që angazhimi profesional për të zgjidhur rastin në rrugë administrative apo gjyqësore, shikohet si domosdoshmëri në kushtet kur Ndihma Ligjore Falas e Garantuar nga shteti nuk funksionon dhe kostot për zgjidhjen e rastit, përfshirë avokatin, shpenzimet e ADN, shpenzimet e tjera gjyqësore e administrative janë të papërballueshme nga familjet apo nga të afërmit e fëmijës. Gjatë 2019, stafi i TLAS ka marrë pjesë në takimet e mëposhtme ku evidentohet përse është kërkuar ndihma ligjore dhe nga kush është organizuar:

Nr.	Date	Problematika	Organizuar
-----	------	--------------	------------

1	16.01.2019	Duhet të kryhej regjistrimi i lindjes së fëmijës KP, djalë i moshës 16 muajsh. Fëmija kishte ngelur i paregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile për më shumë se një vit sepse nëna nuk kishte mundësi financiare të aplikonte për kartë identiteti, kërkesë e domosdoshme kjo për të identifikuar amësinë dhe përfunduar procedurën administrative të regjistrimit civil.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë
2	16.01.2019	Fëmija SM, i moshës 8 vjec, i paregjistruar në gjendjen civile, ose pa identitet e shtetësi njëkohësisht. Përse kjo situatë? Sepse nëna e fëmijës MM kishte deklaruar në Maternitetin e Lezhës të dhëna personale të gabuara dhe një veprim i tillë i papërgjegjshëm i nënës shkaktoi mosregjistrimin e fëmijës duke e lënë atë të “padukshëm” për institucionet e shtetit si, shërbimin social, kopshtin, shjollën, qendrën shëndetësore, e shume të tjera. Në këtë rast koregjimi i të dhënave të pasakta për nënën bëhet vetëm me kërkesë drejtuar gjykatës në këtë rast asaj në Lezhë. Kjo ishte arsye e rëndësishme për të ftuar avokatin e TLAS në takimin e GTN. NJMF duke e dituar që nëna nuk ka mundësi financiare të mbulojë shpenzimet e avokatit që do ta përfaqësojë në gjykatë, ato të analizës së ADN dhe jo vetëm, kërkoi që gjithë kjo punë të asistohej nga TLAS, i cili jo vetëm është i specializuar për të zgjidhur raste të tilla, por edhe mbulon shpenzimet totale [për klientë vulnerabël dhe fëmijët e paregjistruar. Dhe duket si e cuditshme por kjo kategori familjesh edhe pje jetojnë në Tiranë, shpesh regjistrimin civil e kanë në qytetet të tjera gjë që e komplikon edhe më shumë çështjen e shpenzimeve që duhet të përballojnë prindërit për të zgjidhur çështjen e tyre.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Nr. 1 Tiranë
3	20.02.2019	Në këtë takim të GTN, punonjësi i NJMF kishte nevojë të kërkonte Urdhër Mbrojtje për EK, nënën e 2 fëmijëve të mitur respektivisht 12 vjec dhe 10 vjec. Këtë grua e dhunonte vazhdimisht fizikisht bashkeshorti në prezencë të fëmijëve duke krijuar trauma dhe dhunë verbale e psikologjike të drejtpërdrejtë të fëmijët. Nga ana tjetër kjo nënë vazhdonte të duronte një situatë të tillë me pasoja të rënda për personalitetin e fëmijëve, sepse nuk kishte asnjë mbështetje njerzorer apo ekonomike për të marrë një avokat dhe përballuar procesin gjyqësor. Sigurisht TLAS edhe në këtë rast ishte plotësisht i gatshëm të asistojë ligjërisht dhe mbulojë shpenzimet për rastin e referuar që para së gjithash është në interesin më të lartë të fëmijëve dhe nënës së tyre.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë
4	05.02.2019	GTN u mbledh me tematikën për të diskutuar rreth dy çështjeve ligjore që duhet të asistoheshin falas dhe profesionalisht nga TLAS: Zgjidhjen e martesës të SM, nënë e dy fëmijëve respektivisht 5vjec dhe 2 vjec për shkak se ishte braktisur nga bashkeshorti, i cili ishte larguar nga banesa bashkëshortore dhe vazhdonte të mos tregonte treguar interes për familjen e tij.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Bashkisë, Kamëz, Tiranë

		Regjistrimin e lindjes së GG, një vajze e moshës 2 vjeç, e lindur në Greqi. Prindërit e saj dispononi një dokument lindje në formën e paplotë ligjore se nuk kishin marrë për të marrë vulen apostile në shtetin Grek për të finalizuar procedurën sipas ligjit shqiptar dhe regjistruar fëmijën në gjëndjen civile.	
5	22.02.2019	GTN e Vaqarrit këtë herë kishte nevojë për shërbimin ligjor falas dhe për këtë qëllim ftoi posacërisht përfaqësuesin e TLAS dhe konkretisht donte të zgjidhte tre çështje: - Së pari kishin identifikuar që një vajzë LE, e moshës 14 vjeçe ishte ende e paregjistruar në gjendjen civile sepse e kishte braktisur nëna dhe jetonte vetëm me babain. I jati me gjithë perpjekjet e bera nuk kishte mundur të provonte me dokumenta faktin e lindjes me dokumenta sips kerkeses se gjendjes civile. Vajza shkonte në shkollë edhe pse cdo vit i kërkohej dokumenti i identifikimit, dhe si rezultat nuk i leshonin deftesën shkollore. NJMF u informua se në bazë të ndryshimeve të ligjit të gjendjes civile në vitin 2018, kanë përgjegjësinë të ndjekin regjistrimin e lindjes së fëmijëve edhe në rastet kur nëna nose prindi nuk e bën deklarin e lindjes. Në këto kushte TLAS mori përsipër me rrugë gjyqësore të hapi çështjen e vërtetimit të faktit të lindjes në gjykatën e Tiranës. - Së dyti regjistrimi i lindjes u finalizua dhe në bazë të ligjit vajza regjistrohet në emrin e nënës dhe në emrin e babait të prezumuar, sepse ndërkoh nëna ishte martuar jo me babain e vajzës. Ky fakt kërkonte një proces të dytë gjyqësor të hapur në Gjykatën e Tiranës, atë të kundërshtimit të atësisë së prezumuar dhe Njohjen e Atësisë së babait biologjik. Në këtë proces, prova e sjellë nga avokati i TLAS përmes analizës së ADN-se është vendimater dhe e kërkuar nga gjykata, gjë e cila u realizua me mbështetjen financiare të donatorëve të TLAS.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Vaqarr, Tiranë
6	25.02.2019	Një familje e pastrehë, me kryfamiljar ZM dhe me dy fëmijë duhet të aplikojë dhe përfitojë Bonus Qeraje. Shpenzimet e tarifave shtetërore dhe noterioale të plotësimit të dokumentave të kërkuara, që ishin në këtë rast 7200 lekë, ishte e pamunduar të përballoheshin nga familja. TLAS në këtë rast asistoi mbledhjen e dokumentave dhe pagesat e nevojshme të rarifave duke e bërë familjen pjesë dhe përfitues të programit të strehimit nga Bashkia e Tiranës.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë
7	28.02.2019	GTN në këtë rast u mblodh për të vendosur kush do të merrte përsipër përfaqësimin e një rasti kujdestarie në gjykatë. Fëmijët JZ.dhe EZ., respektivisht 16 vjec dhe 14 vjec, jetonin prej shumë	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë

		vitesh me gjyshen e cila nuk përfitonte asnjë mbështetje ekonomike nga shteti sipas ligjit të kujdestarisë sepse nuk njihej ligjërisht si kujdesatë e dy fëmijëve të mitur. Prindërit e vajzave ishin divorcuar në Shqipëri dhe ishin larguar që të dy jashtë shtetit që prej 14 vjetësh më parë. Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve po bëjnë një punë të kujdeshme për të informuar dhe referuar raste të tilla që jo vetëm ju vinë në ndihmë gjyshërve por edhe vet fëmijëve të cilët kanë nevojë të posacme për ushqim, veshje. Libra dhe për shpenzime të tjera të domosdoshme. Sigurish TLAS nuk refuzon mbështetjen e rasteve të tilla dhe përfaqësimin e tyre në gjykatë, duke përdorur me efektivitet fondet e siguruar nëpërmjetë donatorëve. Dhe projekteve të shkruajtura për këtë qëllim.	Administrative Nr. 3, Tiranë
8	15.04.2019	GTN u mbledh për të vendosur që fëmija BV i moshës 8 vjeç, të vihej nën mbrojtje bazuar në Urdhër Mbrojtje të lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor tiranë, sepse nëna e fëmijës në mënyrë të përsëritur nuk kujdesej për të, e neglizhonte dhe e keqtrajtonte në mënyrë të përsëritur. Të gjithë antarët e GTN ishin dakord që të shkohej me këtë objekt në gjykatë dhe të sigurohej urdhëri i mbrojtjes si edhe njëkohësisht të detyrohej nënë të bënte deklaratën noteriale para noterit për të shprehur qartë vullnetin e saj për të dërguar fëmijën 8 vjeç në institucionin e Zyber Hallulli në Tiranë. Deklarata noteriale dhe shpënzimet u asistuan dhe mbuluan nga TLAS.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë
9	10.05.2019	Edhe për këtë rast të ngjashëm TLAS ju përgjigj ftesës së GTN edhe në këtë rast sepse duhet të vendosej për fatin e një fëmije SC, i moshës 1 vjeç, i cili u konstatua që keqtrajtohej prej nënës së tij. Fëmija duhet urgjentisht të vihej nën mbrojtje bazuar në urdhër mbrojtje të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sepse nëna e papërgjegjsme nuk po kujdesej në mënyrë të përsëritur. Rasti u raportua nga fqinjët dhe verifikua nga NjMF e cila veçoi shumë shpejt për të marrë një vendim në interesin më të lartë të fëmijës. Të gjithë antarët e GTN ishin dakord që të shkohej me këtë objekt në gjykatë dhe të sigurohej urdhëri i mbrojtjes si edhe njëkohësisht të detyrohej nënë të bënte deklaratën noteriale para noterit për të shprehur qartë vullnetin e saj për të dërguar fëmijën 8 vjeç në institucionin e Zyber Hallulli në Tiranë. Deklarata noteriale dhe shpënzimet u asistuan dhe mbuluan nga TLAS.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Nr. 12, Tiranë
10	09.05.2019	GTN u propozua të mbledhej për të hapur një proces gjyqësor për zgjidhje të një martese fiktive. TLAS ishte prezent për të dëgjuar, për të verifikuar dhe vendosur nëse ky rast duhej përfaqësuar dhe mbuluar falas me fondet e donatorit të saj. Ishte fjala që gruaja e quajtur PB, ishte martuar thjesht fiktivisht me një burrë i	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Nr. 8, Tiranë

		cili e kishte shpërblyer me një shumë të caktuar parash. Ndërkohë ajo bashkjetonte me një burrë tjetër me të cilin lindi një fëmijë që e quajti FB. Në moshën 2 muaj, djali i vigel, bebe, vdiq sepse në fakt kishte lindur me problem të rënda mjekësore. Dilnin disa probleme ligjore që duhet domosdoshmërisht të zgjidheshin, dhe sigurisht kërkonin arsyetimin e një avokati të specializuar për regjistrimet civile. TLAS sigurisht asistoi dhe vendosi të ndiqte këto hapa: • Se pari të paraqiste në Gjykatë kërkesën për zgjidhje martesë në mënyrë që nëna të ishte e lirë ligjërisht për të ndërmarrë hapat pasues. Përfaqësimin do ta merrte përsipër avokati i TLAS. Mbas zgjidhjes së martesës të bërë për interesa financiare të momentit, nëna kishte ligjërisht të drejtë të regjistronte dhe cregjistronte fëmijën e saj. • Mbas vendimit të zgjidhjes së martesës nëna do të paraqitej për të deklaruar lindjen e fëmijës që e quante FB (tashmë i vdekur) para punonjësit të zyrës përkatëse të gjendjes civile, ku do të mbahej akti i lindjes dhe vënia e emrit të fëmijës; • Po në të njëjtën ditë nëna do të deklaronte aktin e vdekjes në bazë të rrregullave në fuqi, në mënyrë që të kryhej e cregjistrimi i vdekjes së FB. Nevoja e shërbimeve ligjore falas për këto kategori çështjesh është shumë rëndësishme. Në rast të kundërt këto kategori e komplikojnë shumë herë më tepër situatën e tyre familjare dhe përjashtohen nga aksesin në shërbimet sociale të ofruara nga shteti.	
11	09.05.2019	Edhe në këtë rast GTN u mblodh për një familje e pastrehë, me kryefamiljar LK dhe me tre fëmijë që duhet të aplikojë dhe përfitojë Bonus Qeraje. Shpenzimet e tarifave shtetërore dhe notorioale të plotësimit të dokumentave të kërkuara, që ishin në këtë rast 7200 lekë, ishte e pamunduar të përballoheshin nga familja. TLAS në këtë rast asistoi mbledhjen e dokumentave dhe pagesat e nevojshme të tarifave duke e bërë familjen pjesë dhe përfitues të programit të strehimit nga Bashkia e Tiranës.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Nr. 4, Tiranë
12	10.05.2019	GTN në këtë rast u mblodh për të vendosur kush do të merrte përsipër përfaqësimin e një rasti kujdestarie në gjykatë. Fëmija GA 10 vjeç, jetonte prej shumë vitesh me gjyshin i cili nuk përfitonte asnjë mbështetje ekonomike nga shteti sipas ligjit të kujdestarisë sepse nuk njihet ligjërisht si kujdesatë e dy fëmijëve të mitur. Prindërit e fëmijës nuk ishin të martuar, bashkëjetonin në kohën kur lindi fëmijë dhe më pas barktisën njëri tjetrin si edhe fëmijën e tyre. Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve po bëjnë	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Nr. 9, Tiranë

		një punë të kujdeshme për të informuar dhe referuar raste të tilla që jo vetëm ju vinë në ndihmë gjyshërve por edhe vet fëmijëve të cilët kanë nevoja të posacme për ushqim, veshje, libra dhe për shpenzime të tjera të domosdoshme. Sigurisht TLAS nuk refuzon mbështetjen e rasteve të tilla dhe përfaqësimin e tyre ne gjykatë, duke përdorur me efektivitet fondet e siguaruara nëpërmjetë donatorëve dhe projekteve të shkruajtura për këtë qëllim. Ne këtë mbledhje GTN, përfaësuesi i TLAS mori përsipër të zgjidhte edhe rastin e një transferimi të qytetares ML, në situatë vulnerabiliteti, që e kishte gjëndjen civile në Elbasan dhe jetonte në Tiranë, duke mbuluar të gjitha kostot e kërkuara për këtë qëllim dhe krijuar kushtet ligjore për të aksesuar programet sociale ne Tiranë. Së treti TLAS mori përsipër regjistrimin e lindjes së fëmijës EL, 2 vjec, që kishte ngelur i paregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile për më shumë se një vit sepse nëna FL nuk kishte mundësi financiare të aplikonte për kartë identiteti, kërkesë e domosdoshme kjo per të identifikuar amësinë dhe përfunduar procedurën administrative të regjistrimit civil.	
15	03.06.2019	GTN u mbledh për të vendosur që fëmija FP, djalë i moshës 13 vjec, i cili kishte braktisur shkollën mbas divorcit të prindërve të tij. Kjo ndarje u shoqërua me sjellje të pakontrollueshme të fëmijës i cili e vuante këtë situatë në formë agresive. Ndërkohë babai i djalit edhe pse i ndarë vazhdonte të dhunonte ish gruan dhe fëmijën. TLAS kishte bërë divorcin dhe tani duhej të mbështeste edhe hapjen e nje procesi për urdhër mbrojtje të nënës dhe të fëmijës. Sic edhe është bërë praktikë nga GTN vecanërisht në Tiranë, kërkohet në mënyrë të rregullt prezenca e avokatit të TLAS edhe per keshillim ligjor, edhe per te percaktuar rrugen e hapave që duhet te ndiqen deri sa çështja të zgjidhet, edhe për të përfaqësuar në gjykatë rastin, edhe për të mbuluar shpenzimet qofshin dhe të vogla, kur nuk ka mundësi familja ta bëjë një gjë të tillë.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Nr. 10, Tiranë
16	30.10.2019	GTN në këtë rast u mbledh për të vendosur kush do të merrte përsipër përfaqësimin e një rasti kujdestarie në gjykatë. Fëmija AM 8 vjec, jetonte prej shumë vitesh me gjyshen nga babai e cila nuk përfitonte asnjë mbështetje ekonomike nga shteti sipas ligjit të kujdestarisë sepse nuk njihej ligjërisht si kujdesatre e fëmijës së baraktisur nga të dy prindërit. Nëna ishte me të menta mendore, jetonte ne Lushnje dhe nuk kishte asnje burim te ardhurash për t’u kujdesur për djalin dhe as për veten e saj. Shërbimi social dhe komisioni mjeksor përkatës nuk e kanë	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, NjMF, e Njesisë Administrative Nr.11, Tiranë

		shqyrtuar si rast invaliditetit dhe asnjë nuk e asiston këtë grua të re për ta përfshirë në programet sociale. Babai i djali ishte martuar përsëri dhe nuk e kishte marrë fëmijën me vete. Në këto kushte njësia për mbrojtjen e fëmijëve e identifikon dhe e referon në mbledhjen e GTN për ta ndjekur si rast në Gjykatë me mbështetjen e TLAS. Rasti është hapur dhe finalizuar duke e njkohur gjyshen si kujdestare të ligjshme për nipin 8 vjecar.	
--	--	---	--